



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.136

4 tetor

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.613, datë 7.9.2011	Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”.....	6119
Vendim i KM nr.672, datë 14.9.2011	Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë, për ciklin e dytë të studimeve “Master profesional”, për vitin akademik 2011-2012	6170

VENDIM
Nr.613, datë 7.9.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLIT TEKNIK “PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE
VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE NË MJEDISE TË HAPURA NË
LIDHJE ME EMETIMIN E ZHURMAVE”¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLI TEKNIK
**PËR KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E KONFORMITETIT TË PAJISJEVE NË
MJEDISE TË HAPURA NË LIDHJE ME EMETIMIN E ZHURMAVE**

1. QËLLIMI

Ky rregull teknik ka për qëllim të përcaktojë kërkesat e emetimit të zhurmës, procedurat e vlerësimit të konformitetit, markimit, dokumentacionin teknik në lidhje me emetimin e zhurmës së pajisjeve në mjedise të hapura.

2. FUSHA E ZBATIMIT

2.1. Ky rregull teknik zbatohet për pajisjet që përdoren në mjedise të hapura të listuara në pikat 11 dhe 12 dhe mbulon vetëm pajisje që vendoset në treg apo vihet në përdorim si një njësi e tërë e përshtatshme për përdorimin e parashikuar. Përfshihen nga ky rregull teknik pajisjet shitesë që funksionojnë pa energji, të cilat vendosen në treg ose vihen në përdorim më vete, përveç kazmave dhe betonthevesve/matrapikëve që mbahen në dorë dhe për çekanët hidraulikë.

2.2 Përfshihen nga fusha e zbatimit e këtij rregulli teknik pajisjet e mëposhtme:

- a) të gjitha pajisjet e përcaktuara kryesisht për transportin e mallrave ose personave me rrugë ose hekurudhë, rrugë ajrore ose ujore;
- b) pajisjet e projektuara posaçërisht dhe të ndërtuara për qëllime ushtarake dhe policore, si dhe për shërbimet emergjente.

3. PËRCAKTIME

Në këtë rregull teknik, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Pajisje për përdorim në mjedise të hapura” janë të gjitha makineritë e përcaktuara në pikën 1/A të rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e të konformitetit të makinerive”, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1216, datë 13.9.2008, që janë ose vetëlëvizëse, ose mund të lëvizin dhe që, pavarësisht nga elementi/tet lëvizës/e, ka për qëllim të përdoret, sipas tipit të saj, në mjedis të hapur dhe që kontribuon në ekspozimin e zhurmës në mjedis.

¹ 2000L0014-EN-20.4.2009-002.001-1

Përdorimi i pajisjes në një ambient ku transmetimi i tingullit nuk është ose nuk është shumë i prekur/ndikuar (p.sh. nën çadra, nën çati për mbrojtje nga shiu ose në pjesën e jashtme të shtëpive), konsiderohet si përdorim në mjedis të hapur. Gjithashtu, nënkupton edhe pajisje që punojnë pa energji për përdorime industriale ose mjedisore që ka për qëllim, në përputhje me tipin, të përdoret në mjedise të hapura, jashtë dhe që kontribuon në nxjerrjen e zhurmës në mjedis. Të gjithë këta tipa pajisjesh në vijim do të quhen “pajisje”.

b) “Procedura të vlerësimit të konformitetit” janë procedurat e përcaktuara në pikat 22 dhe 25 të këtij rregulli teknik;

c) “Markim” është vendosja e markimit CE në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme dhe e shoqëruar nga treguesi i garantuar i nivelit të fuqisë së tingullit.

d) “Niveli i fuqisë së tingullit LWA” është fuqia e tingulli A në dB në lidhje me 1 pW.

e) “Niveli i matur i fuqisë së tingullit” është një nivel i fuqisë së tingullit siç përcaktohet nga matjet e dhëna në pikën 18. Vlerat e matura mund të përcaktohen ose nga një makinë e vetme, përfaqësuese për tipin e pajisjeve, ose nga niveli mesatar i një numri makinash.

f) “Niveli i garantuar i fuqisë së tingullit” është një nivel i fuqisë së tingullit i përcaktuar në përputhje me kërkesat e dhëna në pikën 18 që përfshin pasaktësitë për shkak të ndryshimit të prodhimit dhe procedurave të matjes, si dhe kur fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar konfirmon/vërteton se sipas instrumenteve teknike të përdorura dhe të përmendura në dokumentacionin teknik nuk është tejkaluar.

4. VENDOSJA NË TREG

4.1. Përpara vendosjes në treg dhe/ose në përdorim të pajisjeve të përcaktuara në pikën 2.1, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar siguron se:

a) pajisja plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik në lidhje me emetimin e zhurmës në mjedis të hapur;

b) procedurat e vlerësimit të konformitetit janë kryer në përputhje me pikën 13 të këtij rregulli teknik;

c) pajisja mban markimin CE dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit dhe është e shoqëruar nga një deklaratë EC e konformitetit.

4.2. Kur as fabrikuesi, as përfaqësuesi i tij i autorizuar nuk plotësojnë detyrimet e këtij rregulli teknik, përgjegjës është personi që vendos pajisjen në treg dhe/ose në përdorim.

5. MBIKËQYRJA E TREGUT

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e nevojshme e parashikuara në ligjin nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore” për të siguruar që pajisja vendoset në treg dhe/ose në përdorim vetëm nëse ajo është në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, mban markimin CE dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit, si dhe shoqërohet nga një deklaratë EC e konformitetit.

6. LËVIZJA E LIRË

6.1. Nuk pengohet, kufizohet ose ndalohet vendosja në treg dhe/ose në përdorim e pajisjeve, të cilat janë në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik, mbajnë markimin CE dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit, si dhe janë shoqëruar me një deklaratë EC të konformitetit.

6.2. Në panairë tregtare apo aktivitete të tilla të ngjashme mund të ekspozohen pajisjet, që nuk janë në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik, vetëm nëse një shënim i dukshëm tregon qartë se një pajisje e tillë nuk është në përputhshmëri dhe se ajo nuk është e vendosur në treg dhe/ose në përdorim deri sa të sillet në përputhshmëri me kërkesat e këtij rregulli teknik nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar. Gjatë demonstrimeve të mospërputhshmërisë të këtyre pajisjeve të merren masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e personave.

7. PREZUMIMI I KONFORMITETIT

Pajisjet të cilat mbajnë markimin CE dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit dhe shoqërohen me deklaratën EC të konformitetit prezumohen në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik.

8. DEKLARATA EC E KONFORMITETIT

8.1. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar i pajisjeve, në mënyrë që të vërtetojë se një pajisje është në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik, harton një deklaratë EC të konformitetit për secilin tip të pajisjeve të prodhuara. Përmbajtja minimale e deklaratës së konformitetit është përcaktuar në pikën 17 të këtij rregulli teknik.

8.2. Deklarata e konformitetit për pajisjet që vendosen në treg dhe/ose në përdorim hartohet ose përkthehet në gjuhën shqipe.

8.3. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, mban një kopje të deklaratës EC të konformitetit së paku 10 vjet nga data e prodhimit të pajisjes së fundit, së bashku me dokumentacionin teknik, siç parashikohet në pikën 22.3, 23.3, 24.2, 25.3.1 dhe pikën 25.3.3 të këtij rregulli teknik.

9. MOSPËRPUTHSHMËRIA E PAJISJES

9.1. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut konstaton se një pajisje, e cila është vendosur në treg dhe/ose përdorim, nuk përputhet me kërkesat e këtij rregulli teknik, ajo merr të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar të sjellë pajisjen në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik.

9.2. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr të gjitha masat e nevojshme për kufizimin ose ndalimin e vendosjes në treg dhe/ose në përdorim të pajisjes ose siguron tërheqjen e saj nga tregu, kur:

- a) vlerat limit të përmendura në pikën 11 janë tejkaluar; ose
- b) vazhdon mospërputhshmëria me kërkesat e tjera të këtij rregulli teknik pavarësisht nga masat e marra sipas pikës 9.1. Në këtë rast struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut njofton menjëherë ministrinë përgjegjëse.

10. MARKIMI

10.1. Pajisja e vendosur në treg dhe/ose në përdorim që është në përputhje me kërkesat e këtij rregulli teknik mban markimin CE të konformitetit. Markimi përbëhet nga inicialet “CE”. Forma e markimit CE jepet në pikën 21 të këtij rregulli teknik.

10.2. Markimi CE shoqërohet nga treguesi i nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit. Modeli i treguesit jepet në pikën 21.

10.3. Markimi CE i konformitetit dhe treguesi i nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit vendosen në çdo pjesë të pajisjes në formë të dukshme, të lexueshme dhe të paheqshme.

10.4. Ndalohet të vendosen mbi pajisje markime ose mbishkrime, të cilat çorientojnë kuptimin e markimit CE, ose treguesit të nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit. Çdo markim tjetër mund të vendoset mbi pajisje, me kusht që të mos reduktojë dukshmërinë dhe lexueshmërinë e markimit CE dhe treguesit të nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit.

10.5. Kur pajisja është objekt edhe i rregullave të tjera teknike, që mbulojnë aspekte të tjera, që, gjithashtu, parashikojnë vendosjen e markimit CE, markimi tregon se kjo pajisje përmbush, gjithashtu, dispozitat e këtyre rregullave teknike. Megjithatë, nëse një ose më shumë prej këtyre rregullave teknike e lejojnë fabrikuesin, gjatë një periudhe kalimtare, të zgjedhë rregullat që do të zbatojë, markimi CE tregon se pajisja plotëson vetëm kërkesat e rregullave teknike të zbatuara nga fabrikuesi. Në këtë rast, pjesët e veçanta të zbatuara të këtyre rregullave teknike, të publikuara në Fletoren Zyrtare, jepen në dokumentet, shënimet ose instruksionet e kërkuara nga këto rregulla dhe që shoqërojnë pajisjen.

11. PAJISJE SUBJEKT PËR KUFIJTË E ZHURMËS

Niveli i garantuar i fuqisë së tingullit i pajisjeve të listuara më poshtë nuk duhet të kalojë nivelin e lejueshëm të fuqisë së tingullit, siç është përcaktuar në tabelat e mëposhtme të vlerave kufitare.

11.1. Ngritësit/çikrikë ndërtimi për transportin e mallrave (që vihen në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme)

Përcaktimi: pika 16.3 matja/masa: pika 20.3.

11.2. Makinat ngjeshëse (vetëm rulet vibruese dhe jovibruese, pllaka dridhëse dhe tokmakë dridhës)

Përcaktimi: pika 16.8, matja/masa: pika 20.8.

11.3. Kompresorë (< 350 kW)
Përcaktimi: pika 16.9, matja/masa: pika 20.9.

11.4. Thyerës betoni dhe gërmues, të mbajtur me dorë
Përcaktimi: pika 16.10, matja/masa: pika 20.10.

11.5. Çikrikë ndërtimi (që punojnë/vihen në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme)
Përcaktimi: pika 16.12, matja/masa: pika 20.12.

11.6. Buldozerë (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.16, matja/masa: pika 20.16.

11.7. Shkarkues (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.18, matja/masa: pika 20.18.

11.8. Ekskavatorë hidraulikë apo që punojnë me litarë (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.20, matja/masa: pika 20.20.

11.9. Ngarkues ekskavatorë (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.21, matja/masa: pika 20.21.

11.10. Nivelues (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.23, matja/masa: pika 20.23.

11.11. Paketa presuese hidraulike
Përcaktimi: pika 16.29, matja/masa: pika 20.29.

11.12. Ngjeshës në vendgroposje të tokës/dherave të tipit ngarkues me kovë (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.31, matja/masa: pika 20.31.

11.13. Kositës bari (me përjashtim të pajisjeve bujqësore dhe pyjore, si dhe pajisjet me shumë qëllime, komponenti kryesor i motorizuar i cili ka një fuqi të instaluar prej më shumë se 20 kW)
Përcaktimi: pika 16.32, matja/masa: pika 20.32.

11.14. Kositës bari/kositës anësor bari
Përcaktimi: pika 16.33, matja/masa: pika 20.33.

11.15. Kamionë ngritës, që vihen në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme, të kundërbalancuar (me përjashtim të “kamionëve të tjerë ngritës të kundërbalancuar” siç përcaktohet në pikën 16.36, paragrafi i dytë me një kapacitet të vlerësuar me jo më shumë se 10 tonë)
Përcaktimi: pika 16.36, matja/masa: pika 20.36.

11.16. Ngarkues (< 500 kW)
Përcaktimi: pika 16.37, matja/masa: pika 20.37.

11.17. Vinça lëvizës
Përcaktimi: pika 16.38, matja/masa: pika 20.38.

11.18. Gërmues me motor (< 3 kW)
Përcaktimi: pika 16.40, matja/masa: pika 20.40.

11.19. Përfundues për shtrim rruge (me përjashtim të përfunduesve për shtrim rruge të pajisur me një rrjetë* me ngjeshje të lartë)
Përcaktimi: pika 16.41, matja/masa: pika 20.41.

11.20. Gjeneratorë energjie (< 400 kW)
Përcaktimi: pika 16.45, matja/masa: pika 20.45.

11.21. Vinça kullë
Përcaktimi: pika 16.53, matja/masa: pika 20.53.

11.22. Gjeneratorë saldimi
Përcaktimi: pika 16.57, matja/masa: pika 20.57.

Tabela 1

Lloji i pajisjes	Fuqia neto e instaluar P (në kW) Fuqia elektrike Pel ¹ në kW Masa/pesha e pajisjes m në kg Gjerësia e prerjes L në cm	Niveli i lejuar i fuqisë së tingullit në dB/1pW	
		Faza e I nga 1 janari 2012	Faza e II nga 1 janari 2013
Makina ngjeshëse (rul vibrues, pllaka vibruese/dridhëse, tokmak dridhës)	$P \leq 8$	108	105 ²
	$8 < P \leq 70$	109	106 ²
	$P > 70$	$89 + 11 \lg P$	$86 + 11 \lg P^2$
Buldozerë me zinxhirë, ngarkues me zinxhirë, ngarkues ekskavator me zinxhirë	$P \leq 55$	106	103 ²
	$P > 55$	$87 + 11 \lg P$	$84 + 11 \lg P^2$
Buldozerë me rrota, ngarkues me rrota, ngarkues ekskavatorë me rrota, automjete shkarkimi, ngjeshës për mbushje dheu të tipit ngarkues, kamionë ngritës të kundërbalancuar që punojnë me motor me djegie të brendshme, vinça të lëvizshëm, makina ngjeshëse (jo rul vibrues), shtrim përfundim rruge, paketa e fuqisë hidraulike	$P \leq 55$	104	101 ^{2 3}
	$P > 55$	$85 + 11 \lg P$	$82 + 11 \lg P^{2 3}$
Ekskavatorë ngritës/citrikë ndërtimorë për transportin e mallrave, vinça ndërtimi, motor shate	$P \leq 15$	96	93
	$P > 15$	$83 + 11 \lg P$	$80 + 11 \lg P$
Betonthyerës dhe matrapikë që mbahen me dorë	$m \leq 15$	107	105
	$15 < m < 30$	$94 + 11 \lg m$	$92 + 11 \lg m$
	$m \geq 30$	$96 + 11 \lg m$	$94 + 11 \lg m$
Vinça kullë		$98 + \lg P$	$96 + \lg P$
Gjeneratorë elektrikë saldimi	$P_{el} \leq 2$	$97 + \lg P_{el}$	$95 + \lg P_{el}$
	$2 < P_{el} \leq 10$	$98 + \lg P_{el}$	$96 + \lg P_{el}$
	$P_{el} > 10$	$97 + \lg P_{el}$	$95 + \lg P_{el}$
Kompresorë	$P \leq 15$	99	97
	$P > 15$	$97 + 2 \lg P$	$95 + 2 \lg P$
Kositës bari, lëndine, kositës anësorë bari	$L \leq 50$	96	94 ²
	$50 < L \leq 70$	100	98
	$70 < L \leq 120$	100	98 ²
	$L > 120$	105	103 ²

¹ Pel për gjeneratorë saldimi: rryma konvencionale e saldimit shumëzuar me tensionin konvencional të ngarkesës për vlerën më të ulët të faktorit, dhënë nga fabrikuesi.

Pel për gjeneratorë energjie: energjia kryesore sipas SSH ISO 8528-1:2008, pika 13.3.2.

² Shifrat për fazën II janë thjesht tregues për llojet e mëposhtme të pajisjeve: - Rul vibrues që ecën mbrapsht;

- Pllaka dridhëse (> 3kW);

- Tokmak dridhës;

- Buldozerë (me zinxhirë çeliku);

- Ngarkues (me zinxhirë çeliku > 55 kW);

- Kamionëngritës të kundërbalancuar që vihen në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme;

- Asfaltues/shtrues/përfundues rruge me rrjetë ngjeshjeje;

- Betonthyerës dhe matrapikë me motor me djegie të brendshme që mbahen në dorë ($15 < m < 30$);

- Kositës bari/kositës lëndine.

³ Për vinçat lëvizës me motor, do të vazhdojnë të aplikohen shifrat për fazën I deri më 1 janar 2012. Pas kësaj date, do të aplikohen shifrat e fazës II.

Niveli i lejuar i fuqisë së tingullit do të rumbullakoset lart ose poshtë në numrin e plotë më të afërt (përdorni numrin e vogël për më pak se 0.5, përdorni numrin e madh për më e madhe se ose e barabartë me 0.5).

12. PAJISJE OBJEKT VETËM I MARKIMIT TË ZHURMËS

Niveli i garantuar i fuqisë së tingullit i pajisjeve të listuara më poshtë, është objekt vetëm i markimit të zhurmës.

12.1. Platforma ajrore me motorë me djegie të brendshme

Përcaktimi: pika 16.1, matja/masa: pika 20.1.

12.2. Kositës shkurreje

Përcaktimi: pika 16.2, matja/masa: pika 20.2.

12.3. Ngritës/çikrikë ndërtimorë për transportin e mallrave (me motor elektrik)

Përcaktimi: pika 16.3, matja/masa: pika 20.3.

12.4. Makina sharre shirit të kantierëve të ndërtimit

Përcaktimi: pika 16.4, matja/masa: pika 20.4.

12.5. Makina sharre diskore të kantierëve të ndërtimit

Përcaktimi: pika 16.5, matja/masa: pika 20.5.

12.6. Sharra, zinxhir portativ

Përcaktimi: pika 16.6, matja/masa: pika 20.6.

12.7. Automjet i kombinuar, thithje dhe shkarkimi me presion të lartë

Përcaktimi pika 16.7, matja/masa: pika 20.7.

12.8. Makina ngjeshëse (vetëm tokmakë shpërthyes)

Përcaktimi: pika 16.8, matja/masa: pika 20.8.

12.9. Përzierës betoni dhe llaçi

Përcaktimi: pika 16.11, matja/masa: pika 20.11.

12.10. Çikrikë ndërtimi (me motor elektrik)

Përcaktimi: pika 16.12, matja/masa: pika 20.12.

12.11. Makina transportuese dhe sprucimi për beton dhe llaç

Përcaktimi: pika 16.13, matja/masa: pika 20.13.

12.12. Ripa transportues

Përcaktimi: pika 16.14, matja/masa: pika 20.14.

12.13. Pajisje ftohëse në automjete

Përcaktimi: pika 16.15, matja/masa: pika 20.15.

12.14. Pajisje shpimi

Përcaktimi: pika 16.17, matja/masa: pika 20.17.

12.15. Pajisje për ngarkimin dhe shkarkimin e cisternave ose siloset në kamionë

Përcaktimi: pika 16.19, matja/masa: pika 20.19.

12.16. Kontejnerë për riciklim qelqi

Përcaktimi: pika 16.22, matja/masa: pika 20.22.

12.17. Kositës bari/ kositës anësor bari

Përcaktimi: pika 16.24, matja/masa: pika 20.24.

12.18. Kositës gardhi

Përcaktimi: pika 16.25, matja/masa: pika aneksi 20.25.

12.19. Larës me presion të lartë

Përcaktimi: pika 16.26, matja/masa: pika 20.26.

12.20. Makina uji me presion të lartë

Përcaktimi: pika 16.27, matja/masa: pika 20.27.

12.21. Çekan hidraulik

Përcaktimi: pika 16.28, matja/masa: pika 20.28.

12.22. Prerës ndarës

Përcaktimi: pika 16.30, matja/masa: pika 20.30.

12.23. Ventilatorë për gjethe

Përcaktimi: pika 16.34, matja/masa: pika 209.34.

12.24. Kolektorë për gjethe

Përcaktimi: pika 16.35, matja/masa: pika 20.35.

12.25. Kamionë ngritës, që vihen në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme të kundërbalancuar (vetëm “kamionë të tjerë ngritës kundërbalancues” siç përcaktohet në pikën 16.36, paragrafi i dytë, me një kapacitet të vlerësuar prej jo më shumë se 10 tonë).

Përcaktimi: pika 16.36, matja/masa: pika 20.36.

12.26. Kontejnerë të lëvizshëm të mbeturinave

Përcaktimi: pika 16.39, matja/masa: pika 20.39.

12.27. Përfundues për shtrim rruge (të pajisur me një rrjetë ** me ngjeshje të lartë)

Përcaktimi: pika 16.41, matja/masa: pika 20.41.

12.28. Pajisje shtyllash

Përcaktimi: pika 16.42, matja/masa: pika 20.42.

12.29. Makina vendosje tubash

Përcaktimi: pika 16.43, matja/masa: pika 20.43.

12.30. Traktor me zinxhir

Përcaktimi: pika 16.44, matja/masa: pika 20.44.

12.31. Gjeneratorë energjie (≥ 400 kW)

Përkufizimi: pika 16.45, matja/masa: pika 20.45.

12.32. Makinë fshirëse me energji

Përcaktimi: pika 16.46, matja/masa: pika 20.46.

12.33. Mjet transporti mbledhës mbeturinash

Përcaktimi: pika 16.47, matja/masa: pika 20.47.

12.34. Makina përpunimi/bluarje rrugësh

Përcaktimi: pika 16.48, matja/masa: pika 20.48.

12.35. Shkrifërues

Përcaktimi: pika 16.49, matja/masa: pika 20.49.

12.36. Copëtues/grirës

Përcaktimi: pika 16.50, matja/masa: pika 20.50.

12.37. Makina borëheqëse me mjete rrotulluese (vetëlëvizëse, me përjashtim të shtesave)

Përcaktimi: pika 16.51, matja/masa: pika 20.51.

12.38. Automjete thithëse

Përcaktimi: pika 16.52, matja/masa: pika 20.52.

12.39. Gërmues

Përcaktimi: pika 16.54, matja/masa: pika 20.54.

12.40. Kamion përzierës

Përcaktimi: pika 16.55, matja/masa: pika 20.55.

12.41. Njësitë e pompave të ujit (jo për përdorim nën ujë)

Përcaktimi: pika 16.56, matja/masa: pika 20.56.

13. VLERËSIMI I KONFORMITETIT

13.1 Para vendosjes në treg dhe/ose në përdorim të çdo pajisjeje të referuar në pikën 11, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar kryen për çdo tip pajisjeje njëren prej procedurave të vlerësimit të konformitetit, si më poshtë vijon:

a) kontrollin e brendshëm të prodhimit me vlerësimin e dokumentacionit teknik dhe procedurën e kontrollit periodik të referuar në pikën 23; ose

b) procedurën e verifikimit të njësisë së referuar në pikën 24; ose

c) procedurën e sigurimit të plotë të cilësisë referuar në pikën 25.

13.2. Para vendosjes në treg dhe/ose në shërbim për çdo tip të pajisjeve të referuara në pikën 12 fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, kryen procedurën të kontrollit të brendshëm të prodhimit të referuar në pikën 22 të këtij rregulli teknik.

14. ORGANET E AUTORIZUARA

14.1. Ministri përgjegjës për tregtinë autorizon organet e vlerësimit të konformitetit për të kryer ose mbikëqyrur procedurat e vlerësimit të konformitetit të referuara në pikën 13.1.

14.2. Ministri autorizon vetëm organe që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 26 të këtij rregulli teknik.

14.3. Ministria përgjegjëse publikon në faqen e saj në internet listën e organeve të autorizuar, së bashku me detyrat dhe procedurat e shqyrtimit, për të cilat janë autorizuar, si edhe numrat e tyre të identifikimit. Ministria siguron që kjo listë të mbahet e përditësuar.

14.4. Ministri përgjegjës tërheq autorizimin, nëse konstaton se organi i autorizuar nuk i plotëson më kriteret e përcaktuara në pikën 26 të këtij rregulli teknik.

15. MBLEDHJA E TË DHËNAVE

15.1. Përpara vendosjes në treg/në përdorim, fabrikuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi dërgon pranë ministrisë përgjegjëse dhe strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut një kopje të deklaratës së konformitetit për çdo tip pajisjeje që referohet në pikën 2.1.

15.2. Ministria grumbullon të dhënat sipas paragrafit të mësipërm për të gjitha pajisjet dhe i publikon këto të dhëna në faqen zyrtare të saj, të cilat përditësohen periodikisht, mundësisht çdo vit.

15.3. Këto të dhëna për çdo tip apo model pajisjeje, përmbajnë të paktën:

- fuqinë e instaluar neto ose ndonjë tregues tjetër në lidhje me zhurmën;
- nivelin e matur të fuqisë së tingullit;
- nivelin e garantuar të fuqisë së tingullit;
- përshkrimin e pajisjes;
- emrin e fabrikuesit ose të markës tregtare;
- numrin ose emrin e modelit.

16. PËRCAKTIMI I PAJISJEVE

16.1. Platforma ajrore me motorë me djegie të brendshme

Quket pajisja që përbëhet minimalisht nga një platformë pune, një strukturë e zgjatur dhe një shasi. Platforma e punës është një platformë e rrethuar ose një kafaz që mund të zhvendoset e ngarkuar në pozicionin e kërkuar të punës. Struktura e zgjatur është e lidhur me shasinë dhe mban platformën e punës. Ajo lejon lëvizjen e platformës së punës në pozicionin e saj të kërkuar.

16.2. Kositës shkurreje

Një njësi e lëvizshme që mbahet me dorë që punon me motor me djegie të brendshme, e pajisur me një teh/thikë rrotulluese prej metali apo plastike me qëllim për të prerë barëra të këqija, shkurre, pemë të vogla dhe bimësi të ngjashme. Pajisja e prerjes vepron në një plan afërsisht paralel me tokën.

16.3. Ngritës/çikrikë ndërtimorë për transportin e mallrave

Një ngritës/çikrik ndërtimor, që punon me energji, i instaluar përkohësisht me qëllim për t'u përdorur nga personat që janë të lejuar të hyjnë në sheshe inxhinierie dhe ndërtimi. Ky u shërben:

i) niveleve të përcaktuara të uljes, që kanë një platformë:

- të projektuar vetëm për transportin e mallrave;
- që lejon hyrjen e personave gjatë ngarkimit dhe shkarkimit;
- që lejon hyrjen dhe lëvizjen e personave të autorizuar gjatë montimit, çmontimit dhe mirëmbajtjes;

- e udhëzuar;

- që lëviz vertikalisht ose përgjatë një rruge maksimumi 15° nga vertikalia;

- të mbështetur ose të mbajtur nga: tel, litar, zinxhir, bosht i përdredhur dhe dado/kundërdado, skarë dhe ingranazh, krik hidraulik (direkt ose indirekt) ose një mekanizëm lidhjeje i zgjerueshëm;

- ku shtyllat mundet ose jo të duan mbështetje nga struktura të veçanta/ndara; ose

ii) një uljeje të sipërme ose të një zone pune që zgjatet deri në fund të udhëzuesit (p.sh. një çati), që ka një pajisje për të mbajtur ngarkesë:

- të projektuar vetëm për transportin e mallrave;

- të projektuar që nuk ka nevojë për të ecur mbi të, për qëllim ngarkimi ose shkarkimi ose për mirëmbajtje, montim dhe çmontim;

- tek e cila njerëzit janë të ndalur në çdo kohë;

- të udhëzuar;

- që është e projektuar për të lëvizur në një kënd të paktën 30° nga vertikalia, por mund të përdoret në çdo kënd;

- të mbajtur me litar me tela çeliku dhe një sistem pozitiv drejtimi;
- të kontrolluar nga kontrolle të tipit me presion konstant;
- që nuk përfiton nga përdorimi i çdo kundërpeshe;
- që është projektuar për një ngarkesë maksimale të vlerësuar prej 300 kg;
- të projektuar për një shpejtësi maksimale prej 1 m/s; dhe
- ku drejtuesit e pajisjes kërkojnë mbështetje nga struktura të veçanta/ndara.

16.4. Makina sharre shirit të kantierëve të ndërtimit

Një makinë me fuqi manuale, që peshon më pak se 200 kg, e pajisur me një teh sharre të vetëm, në formën e një bande të vazhdueshme të montuar në të dhe përgjatë në mes të dy ose më shumë pulexhove.

16.5. Makina sharre diskore të kantierëve të ndërtimit

Një makinë manuale që peshon më pak se 200 kg, e pajisur me një teh sharre të vetëm (përveç një sharre shënuese), me një diametër prej 350 mm ose më shumë, deri në një diametër maksimal prej 500 mm, e fiksuar gjatë punës normale të prerjes. Kjo makinë është e pajisur edhe me një tavolinë horizontale, ku e gjitha apo një pjesë e së cilës është e fiksuar gjatë funksionimit. Tehu i sharrës është i montuar mbi një bosht horizontal pa pjerrësi, pozicion i cili mbetet i palëvizshëm gjatë punës. Makina mund të ketë një nga veçoritë e mëposhtme:

- mundësinë që tehu i sharrës të ngrihet dhe ulet përmes tavolinës;
- skeleti i makinës poshtë tavolinës mund të jetë i hapur ose i mbyllur;
- sharra mund të pajiset me një tavolinë lëvizëse manuale shtesë (jo ngjitur me tehun e sharrës).

16.6. Sharrat zinxhirë portativë

Një mjet që vihet në punë me energji, projektuar për të prerë dru me një zinxhir sharre dhe përbëhet nga një njësi kompakte e dorezave, burimi i energjisë dhe mënyrën e prerjes, projektuar për t'u mbajtur me dy duar.

16.7. Automjetet i kombinuar thithje dhe shkarkim me presion të lartë

Një automjet që mund të punojë si mjet thithjeje ose si shkarkues me presion të lartë. Shih, automjet thithjeje dhe shkarkues me presion të lartë.

16.8. Makinë ngjeshëse

Një makinë që ngjesh materiale, p.sh. mbushje gurësh, tokë ose sipërfaqe të asfaltuar, nëpërmjet veprimit rrokullisës, ngjeshës ose vibrimit të mjetit të punës. Ajo mund të jetë vetëlëvizëse, tërheqëse, e shoqëruar nga pas ose një pjesë makine që e lëviz.

Makinat ngjeshëse ndahen si vijon:

- rule që drejtohen nga operatorë: makina ngjeshëse, vetëlëvizëse me një ose më shumë tambura cilindrikë metalikë, ose goma llastiku, vendqëndrimi i operatorit është një pjesë përbërëse e makinerisë/ës;
- rule që tërhiqen: makina ngjeshëse, vetëlëvizëse me një ose më shumë tamburë cilindrikë metalikë, ose goma llastiku në të cilat pajisjet e funksionimit për lëvizje, drejtim, frenim dhe vibrim janë të vendosura në mënyrë të tillë që makinat të vihen në punë nga një operator shoqëruar ose me telekomandë;
- rule rimorkio: makina ngjeshëse, me një ose më shumë tamburë cilindrikë metalikë, ose goma llastiku, të cilat nuk kanë një sistem të pavarur drejtimi dhe ku vendqëndrimi i operatorit gjendet në një njësi tërheqëse;
- pllaka vibruese dhe tokmak vibrues: makina ngjeshëse me pllaka kryesisht me fund të sheshtë, të cilat janë bërë të vibrojnë. Ato vihen në punë nga një operator shoqëruar ose si një pjesë në makinën e transportit;
- tokmak shpërthimi: makina ngjeshëse, kryesisht me një fletë të sheshtë si mjet ngjeshës i cili është bërë për të lëvizur në një drejtim kryesisht vertikal nga presioni i shpërthimit. Makina përdoret nga një operator shoqëruar.

16.9. Kompresor

Çdo makinë për përdorim me pajisje të këmbyeshme që preson ajrin, gaze ose avuj në një presion më të lartë se presioni hyrës. Një kompresor përfshin vetë kompresorin e zhveshur, forcë

kryesore lëvizëse dhe çdo element apo pajisje të përfshirë, të cilat janë të nevojshme për punën e sigurt të kompresorit.

Përfshihen kategoritë e pajisjeve të mëposhtme:

- ventilatorë, p.sh. pajisje që prodhojnë qarkullim ajri në një presion pozitiv jo më shumë se 110 000 paskalë;

- pompa vakuumi, p.sh. pajisjet për nxjerrjen e ajrit nga një hapësirë e mbyllur nën një presion që nuk tejkalon presionin atmosferik;

- motorët me turbinë gazi.

16.10. Betonhyerës dhe matrapikë, që mbahen me dorë

Betonhyerës me energji (prej çfarëdo metode) dhe matrapikë të përdorur për të kryer punë në inxhinieri civile dhe vendet e ndërtimit.

16.11. Përzierës betoni ose llaçi

Një makinë për të përgatitur beton ose llaç, pavarësisht nga procesi i ngarkimit, përzierjes dhe zbrazjes. Ajo mund të përdoret me ndërprerje ose vazhdimisht.

Përzierës betoni në kamionë quhen kamionët përzierës (shih përcaktimin 16.55).

16.12. Çikrikë ndërtimi

Një pajisje ngritëse që punon përkohësisht me energji e instaluar, e cila është e pajisur me mjete për të ngritur dhe ulur një ngarkesë pezull.

16.13. Makinë transportuese dhe sprucimi për beton dhe llaç

Implant që pompon dhe sprucon beton ose llaç, me ose pa tundës, ku materiali për t'u transportuar përcillet në pozicionin e vendosjes përmes tubacioneve, pajisjeve të shpërndarjes ose krahë të shpërndarjes.

Transportimi kryhet mekanikisht për:

- për beton, mekanikisht, me pompa me piston ose elikë;

- për llaç, mekanikisht me piston, bosht spiral, tub dhe pompa me elitë ose në mënyrë pneumatike nga kompresorë me ose pa dhoma ajri.

Këto makina mund të jenë të montuara mbi kamionë, rimorkio ose automjete të veçanta.

16.14. Rripa transportues

Një makinë e instaluar përkohësisht e përshtatshme për transportin e materialeve me anë të një rripi që vihet në punë me energji.

16.15. Pajisje ftohëse në automjete

Një njësi ngarkesë ftohëse/ngrirëse mbi kategoritë e automjeteve N2, N3, O3 dhe O4

Njësia ftohëse mund të marrë energji me anë të një pjese përbërëse të njësive ftohëse, një pjese të veçantë të vendosur në trupin e automjetit, një motor lëvizës të automjetit, ose nga një burim energjie i pavarur ose gatishmërie.

16.16. Buldozer

Një makinë vetëlëvizëse me rrota ose me zinxhir që përdoret për të ushtruar një forcë shtytëse ose tërheqëse nëpërmjet pajisjes së montuar.

16.17. Pajisje shpimi

Një makinë që përdoret në vendet e ndërtimit për shpimin e vrimave me:

- shpim me goditje;

- shpim rrotullues;

- shpim rrotullues me goditje.

Pajisjet e shpimit janë të palëvizshme gjatë shpimit. Ato mund të lëvizin nga një vend pune në një tjetër, me energjinë e tyre. Pajisjet e shpimit vetëlëvizëse përfshijnë ato të montuara mbi kamionë, shasi me rrota, traktorë, makinë me rrëshqitje, baza rrëshqitëse (të tërhequra me çikrik). Kur pajisjet e shpimit janë të montuara mbi kamionë, traktorë dhe rimorkio ose me bazë rrote, transporti mund të kryhet me shpejtësi të lartë dhe në rrugë publike.

16.18. Shkarkues

Një makinë vetëlëvizëse me rrota ose makinë rrëshqitëse që ka një trup të hapur, e cila ose transporton dhe zbraz, ose shpërndan materiale. Shkarkueset mund të jenë të pajisura me pajisje përbërëse vetëngarkuese.

16.19. Pajisje për ngarkimin dhe shkarkimin e siloseve ose cisternave mbi kamionë

Pajisje me energji të vendosura në silos apo kamioni cisternë për ngarkimin ose shkarkimin e lëngjeve ose materiale të ngurta me anë të pompave apo pajisjeve të ngjashme.

16.20. Ekskavator hidraulik ose që punon me litar

Një makinë vetëlëvizëse rrëshqitëse ose me rrota që ka një strukturë të sipërme të aftë për një rrotullim prej minimumi 360°, i cili gërmon, rrotullohet dhe zbraz materiale nga veprimi i një kove, e vendosur te krahu ose krahu teleskopik, pa lëvizur shasinë ose pjesën e lëvizshme gjatë çdo cikli të makinës.

16.21. Ngarkues ekskavator

Një makinë vetëlëvizëse me rrota ose rrëshqitëse, që ka një mbështetje strukturore kryesore projektuar për të mbajtur edhe një mekanizëm për të ngarkuar kovën e montuar përpara edhe një thikë të vendosur në fund të saj. Kur përdoret thika e pasme, makina normalisht gërmon nën nivelin e tokës me lëvizje kove drejt makinës. Thika e pasme ngre, rrotullon dhe shkarkon materiale, ndërkohë që makina është e palëvizshme. Kur përdoret ngarkuesi, makina ngarkon ose gërmon përmes lëvizjes përpara të makinës, dhe ngre, transporton dhe shkarkon material.

16.22. Kontejnerë për riciklim qelqi

Një kontejner, i ndërtuar me çfarëdolloj materiali, që përdoret për mbledhjen e shisheve. Ai është i pajisur me të paktën një hapje për t'u mbushur me shishe dhe një tjetër për të zbrazur kontejnerin.

16.23. Nivelues

Një makinë vetëlëvizëse me rrota që ka një teh të rregullueshëm, të pozicionuar ndërmjet pjesës së përparme dhe pasme të boshtit, i cili pret, lëviz dhe përhap material zakonisht për kërkesa nivelimi.

16.24. Kositës bari/kositës bari anësor

Një njësi e lëvizshme manuale që punon/vihet në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme, e pajisur me linjë(a) të përkulshme, fije ose elemente të ngjashme jometalike elastike prerëse, të tilla si prerëse rrotulluese, të destinuara për të prerë barërat e këqija, bar apo bimësi të ngjashme të buta. Pajisja prerëse vepron në një plan gati paralel (barkositëse) ose pingul (kositëse anësore bari) me tokën.

16.25. Kositës gardhi

Pajisje manuale që vihet në lëvizje tërësisht me energji, e cila është e projektuar për t'u përdorur nga një operator për të prerë gardhe dhe shkurre duke përdorur reciprokisht një ose më shumë tehe prerës.

16.26. Larës me presion të lartë

Një automjet i pajisur me një pajisje për të pastruar kanalet apo instalime të ngjashme me anë të një pompe uji me presion të lartë. Pajisja mund të jetë ose e montuar mbi një shasi kamioni automjetesh ose të përfshira në shasinë e saj. Pajisja mund të jetë e fiksuar ose e çmontueshme si në rastin e një sistemi të shkëmbyeshëm.

16.27. Makina uji me presion të lartë

Një makinë me grykëza ose hapje të tjera që rrisin shpejtësinë, të cilat lejojnë ujin edhe me përzierje, të dalë si çurke me forcë. Në përgjithësi, makinat e ujit me presion të lartë përbëhen nga një makinë, një gjenerator presioni, linja tubash, pajisje spërkatje, mekanizma sigurie, kontrollues dhe pajisje matjeje.

Makina uji me presion të lartë mund të jenë të lëvizshme ose të palëvizshme:

- makina uji me presion të lartë të lëvizshme, makina të gatshme për transport të krijuara për t'u përdorur në vende të ndryshme, dhe për këtë qëllim janë të pajisura në përgjithësi në shasinë e tyre qendrore ose janë të montuara në automjet. Të gjitha linjat e nevojshme për furnizim janë të përkulshme dhe që stakohen lehtë;

- makina uji me presion të lartë të palëvizshme që janë projektuar për t'u përdorur në një vend për një kohë të gjatë, por të afta për t'u zhvendosur në një vend tjetër me pajisjet përkatëse. Në përgjithësi të montuara në strukturë ose rrëshqitëse me linjë furnizimi në gjendje për t'u stakuar.

16.28. Çekan hidraulik

Pajisjet që përdorin burime energjie hidraulike të makinës mbartëse për të përshpejtuar një piston (ndonjëherë i asistuar me gaz), i cili më pas godet një mjet. Vala e shtypjes e krijuar nga veprimi kinetik rrjedh në brendësi të materialit, e cila shkakton thyerjen e materialit. Çekanët hidraulikë kërkojnë një furnizimin me vaj të presuar për të funksionuar. E gjithë njësia mbajtëse e çekanit kontrollohet nga një operator, zakonisht i ulur në kabinën e transportit.

16.29. Paketë e fuqisë hidraulike

Çdo makinë për përdorim me pajisje të këmbyeshme që presojnë lëngje në një presion më të lartë se presioni hyrës. Do të thotë një bashkim i një force kryesore lëvizëse, pompe, me ose parazervuar dhe pajisjeve (p.sh. kontrollues, valvulin e shkarkimit të presionit).

16.30. Prerës ndarës

Një makinë e lëvizshme e destinuar për prerjen e ndarjeve në beton, asfalt dhe sipërfaqeve të ngjashme në rrugë. Mjeti prerës është një disk rrotullues me shpejtësi të lartë. Lëvizja përpara e prerësit ndarës mund të jetë:

- me dorë;
- me dorë dhe asistencë mekanike;
- që vihet në punë me energji.

16.31. Ngjeshës në vendgroposje të tokës/dherave, të tipit ngarkues me kovë

Një makinë ngjeshëse vetëlëvizëse me rrota që ka një lidhje për ngarkim të montuar para me një kovë që ka rrota çeliku projektuar kryesisht për të ngjeshur, lëvizur, niveluar dhe të ngarkojë, dhe për mbushje dheu ose materiale higjienike (mbeturina).

16.32. Kositëse bari

Makinë barprerëse e shoqëruar nga pas ose që i vendoset një makinë me shtojcë barprerëse, ku pajisja e prerjes vepron në një plan afërsisht paralel me tokën dhe që përdor tokën për të përcaktuar lartësinë e prerjes me anë të rrotave, ajrit jastëk apo rrëshqitëse etj, dhe që përdor motor ose motor elektrik për burim energjie. Pajisjet prerëse janë:

- elemente të ngurtë prerje; ose
- linja filamentesh jometalike apo prerës jometalik që rrotullohet lirisht me një energji kinetike prej më shumë se 10 J secili; energjia kinetike përcaktohet duke përdorur SSH EN 786:2010, aneksi B.

Gjithashtu, kositëse bari është një makinë barprerëse që shtyhet nga pas prej një operatori ose që i vendoset një makinë shtojcë barprerëse, ku pajisja e prerjes rrotullohet rreth një boshti horizontal që të sigurojë një veprim prerjeje me një shufër prerëse të palëvizshme ose thikë (kositës cilindër).

16.33 Kositëse bari/kositës anësor bari

Një makinë me energji elektrike që shtyhet nga pas prej një operatori ose mbahet në dorë, që pret bar me elemente prerëse me linjë(a) filamenti jometalik(e) ose prerës jometalikë që rrotullohen lirisht me një energji kinetike jo më shumë se 10 J secili, me qëllim për të prerë bar ose bimësi të butë të ngjashme. Elementi(et) prerës(e) veprojnë në një plan gati paralel (makinë prerëse lëndinë) ose pingul (lëndinë buzë makinë prerëse) me tokën. Energjia kinetike përcaktohet duke përdorur SSH EN 786:2010, aneksi B.

16.34 Ventilatorë për gjethe

Një makinë me energji e përshtatshme për të pastruar fushat me bar, udhët, kalimet, rrugët etj., nga gjethet dhe materiale të tjera nëpërmjet lëvizjes me shpejtësisë së lartë të ajrit. Ajo mund të jetë portative (që mbahet me dorë) ose joportative, por e lëvizshme.

16.35 Kolektorë për gjethe

Një makinë me energji e përshtatshme për mbledhjen e gjetheve dhe mbeturinave të tjera duke përdorur një pajisje thithjeje të përbërë nga një burim energjie që prodhon një vakum brenda makinës dhe një hundëze thithjeje dhe një kontejner për materialin e mbledhur.

Ajo mund të jetë portative (që mbahet me dorë) apo joportative, por e lëvizshme.

16.36. Kamionë ngritës, që vihen në lëvizje nga motorë me djegie të brendshme, të kundërbalancuar

Një kamion ngritës me rrota, që vihet në lëvizje nga motor me djegie të brendshme me pajisje ngritjeje dhe kundërpeshe (shtizë/direk, krah teleskopik ose krah me nyje). Këto janë:

- kamionë për terren të ashpër (kamionë me rrota të kundërbalancuar të destinuar kryesisht për punë në terren natyror jo të përmirësuar dhe në terren të çrregulluar, p.sh. vendet e ndërtimit);
- kamionë të tjerë ngritës të kundërbalancuar, duke përjashtuar ato kamionë ngritës të kundërbalancuar që janë ndërtuar në mënyrë specifike për trajtimin e kontenierëve.

16.37. Ngarkues

Një makinë me rrota ose rrëshqitëse vetëlëvizëse që ka një lidhje dhe strukturë përbërëse kovëmbështetëse të montuar përpara e cila ngarkon ose gërmon përmes lëvizjes përpara të makinës, dhe heq, transporton dhe shkarkon materiale.

16.38. Vinç lëvizës

Një krah vinçi i vetëfuqizuar i aftë të udhëtojë, i ngarkuar apo jo, pa nevojën e rrugëkalimit të fiksuar dhe që mbështetet te graviteti për stabilitet. Ai funksionon mbi goma, rrëshqitëse ose me rregullime të tjera të lëvizshme. Në pozicione fikse/të caktuara ai mund të mbështetet nga krahë ose pajisje të tjera që rrisin stabilitetin e tij. Konstruksioni i vinçit lëvizës mund të jetë i llojit të rrotullimit rrethor të plotë, me rrotullim të kufizuar ose jorrotullues. Ai është i pajisur normalisht me një ose më shumë çikrikë dhe/ose cilindra hidraulikë për ngritjen dhe uljen e krahut dhe ngarkesës. Vinçat lëvizës janë të pajisur ose me krahë teleskopik, me krahë me nyje, me krahë grilë, ose një kombinim i këtyre, me një projektim të tillë që mund të jetë i gatshëm të ulet. Ngarkesat në gjendje pezull nga krahui i vinçit mund të trajtohen nga bashkimet blloku i ganxhës ose shtojca të tjera që ngrenë ngarkesë për shërbime të veçanta.

16.39. Kontejnerët e lëvizshëm të mbeturinave

Një kontejner i përshtatshëm i projektuar dhe pajisur me rrota për qëllim ruajtje të mbeturinave përkohësisht, dhe e pajisur me një mbulesë.

16.40. Shat me motor

Një makinë vetëlëvizëse e projektuar që të jetë e kontrolluar nga këmbësori:

- me ose pa rrotë/a mbështetëse, në mënyrë të tillë që elementet e saj të punës të veprojnë si mjete gjermuese për të siguruar shtytjen (gjermues me motor); dhe
- shtytjen nga një ose disa rrota të vëna në lëvizje drejtpërdrejt nga motori dhe të pajisur me mjete gjermuese (shat me motor me rrota).

16.41. Përfundues për shtrim rruge

Një makinë e lëvizshme për ndërtim rrugësh që përdoret me qëllim të aplikimit të shtresave të materialit ndërtimor, si p.sh. përzierje bituminoze, betoni dhe zhavorri në sipërfaqe. Përfunduesi i shtrimit të rrugës mund të jetë i pajisur me një rrjetë* me ngjeshje të lartë.

16.42. Pajisje shtyllash

Pajisje të nxjerrjes dhe vendosjes të shtyllave, p.sh. çekiçë goditës, nxjerrës, vibrues ose pajisje të heqjes dhe vendosjes të shtyllave statike të një tërësie makinash dhe përbërësish të përdorur për vendosje ose nxjerrjen e shtyllave, i cili përfshin, gjithashtu:

- pajisje shtylle si pjesë përbërëse e makinës transportuese (rrëshqitëse, e montuar me rrota apo binarë, shtojcë drejtuese qarkulluese, sistem drejtues ose komandues);
- aksesore, p.sh. kapak shtylle, helmeta, pllaka, shoqërues, pajisje fiksuese, pajisje për lëvizje shtyllash, udhëzues shtyllash, mbrojtës akustikë dhe pajisje për zbutjen e vibrimeve, gjeneratorë energjie dhe pajisje për ngritje personale, ose platforma.

16.43. Makina vendosje tubash

Një makinë me rrota ose rrëshqitëse vetëlëvizëse e projektuar veçanërisht për të trajtuar dhe vendosur tuba dhe të transportojë pajisje të tubacionit. Makina, projekti i së cilës bazohet në një traktor, ka komponent të projektuar posaçërisht për të, të tilla si: shasia, struktura kryesore, kundërpeshë, mekanizëm krahui lëvizës dhe ngarkesëngritës, dhe krah lëvizës anësor me rrotullim vertikal.

16.44. Shkrep pistash bore

Një makinë rrëshqitëse vetëlëvizëse që përdoret për të ushtruar një forcë shtytjeje ose tërheqëse në borë dhe akull nëpërmjet pajisjeve të montuara.

16.45. Gjenerator energjie

Çdo pajisje që përbëhet nga një motor me djegie të brendshme që vë në lëvizje një gjenerator elektrik rrotullues që prodhon furnizim të vazhdueshëm të energjisë elektrike.

16.46. Makinë fshirëse me energji

Një makinë fshirëse-mbledhëse që ka pajisje për të pastruar copa materiali brenda rrugës së hyrjes thithëse që më pas përcillet në mënyrë pneumatike nëpërmjet një rryme ajri me shpejtësi të lartë ose me një sistem mekanik ngritës në një mbajtës mbledhës të copave. Pajisjet fshirëse dhe mbledhëse mund të jenë ose të montuara mbi një shasi kamioni automjesh ose të përfshira brenda shasisë së vet. Pajisja mund të jetë fikse ose e çmontueshme, si në rastin e një sistemi të konstruksionit të shkëmbyeshëm.

16.47. Mjet transporti mbledhës mbeturinash

Një mjet i projektuar për mbledhjen dhe transportimin e mbeturinave shtëpiake dhe të rënda në bazë të ngarkimit nëpërmjet kontejnerëve ose me dorë. Automjeti mund të jetë i pajisur me një mekanizëm ngjeshës. Një automjet mbledhës mbeturinash përbëhet nga një shasi me kabinë mbi të cilën është montuar skeleti. Ai mund të pajiset me një pajisje për ngritjen e kontejnerëve.

16.48. Makinë përpunimi/bluarje rrugësh

Një makinë lëvizëse e përdorur për të hequr materiale nga sipërfaqe të shtruara duke përdorur një trup cilindrik që vihet në punë me energji, në sipërfaqen e së cilës janë vendosur mjete bluarëse, tamburatë prerës rrotullohen gjatë operacionit prerës.

16.49. Shkrifërues

Një makinë me energji që shtyhet nga pas prej operatorit, e cila përdor token për të përcaktuar thellësinë e prerjes dhe që është e pajisur me një montim të përshtatshme për të çarë ose gërvishtur sipërfaqen e lëndinës në kopshte, parqe dhe zona të tjera të ngjashme.

16.50. Copëtues/grirës

Një makinë me energji e projektuar për përdorim në një pozicion të palëvizshëm që ka një ose më shumë pajisje prerëse, me qëllim reduktimin e pjesëve të mëdha të materialeve organike në copa të vogla. Në përgjithësi ajo përbëhet nga një ushqyes nëpërmjet të cilës futet materiali (i cili mund të mbahet nga një pajisje ose jo), një pajisje që pret materialin me çfarëdoq metode (prerje, copëtim, thërrmim ose metoda të tjera) dhe një govatë shkarkimi përmes të cilës materiali i prerë shkarkohet. Mund të vendoset edhe një pajisje mbledhëse.

16.51. Makinë borëheqëse me mjete rrotulluese

Një makinë me të cilën bora mund të hiqet nga zonat e trafikut me mjete rrotulluese, përshpejtuar dhe nxjerre me anë të fryrjes.

16.52. Automjete thithëse

Një automjet i pajisur me një pajisje për të mbledhur ujë, baltë, llum, plehra ose materiale të ngjashme nga kanalizimet ujore ose instalime të ngjashme me anë të një vakuumi. Pajisja mund të jetë e montuar mbi një shasi kamioni automjesh ose e përfshira në shasisë së vet. Pajisja mund të jetë e fiksuar ose e çmontueshme si në rastin e një sistemi konstruksioni të shkëmbyeshëm.

16.53. Vinç kullë

Një krah vinçi i rrotullueshëm i vendosur në majën e një kulle që qëndron gati vertikal në pozicionin e punës. Kjo pajisje që punon me energji është e pajisur me mjete për ngritjen dhe uljen e ngarkesave pezull dhe për lëvizjen e ngarkesave të tilla, duke i ndryshuar rrezet e ngritjes së ngarkesës, kthesën, trajektoren e komplet pajisjes. Pajisje të veçanta kryejnë disa lëvizje, por jo medoemos të gjitha nga këto lëvizje. Pajisja mund të instalohet në një pozicion të caktuar ose është pajisur me mjete për zhvendosje ose ngjitje lart.

16.54. Gërmues

Një makinë me rrota ose rrëshqitëse vetëlëvizëse, hipur mbi të ose e kontrolluar nga njeriu, që ka një lidhje dhe shtesë ekskavatori të montuar para ose mbrapa, projektuar kryesisht për të realizuar gërmime me një veprim të pandërprerë, nëpërmjet lëvizjes së makinës.

16.55. Kamion përzierës

Një mjet transporti, i cili është i pajisur me një tambur për të transportuar beton që përzieret, i gatshëm nga fabrika betonpërzierëse në vendin e punës; tamburi mund të rrotullohet kur

makina është në lëvizje apo e qëndruar. Tamburi zbrazet në vendin e punës duke rrotulluar tamburin. Tamburi vihet në lëvizje ose nga motori lëvizës, ose nga një motor suplementar.

16.56. Njësia e pompës së ujit

Një makinë e përbërë nga vetë pompa e ujit dhe sistemi i drejtimit. Pompa e ujit nënkupton një aparat për ngritjen e ujit nga një nivel energjie të ulët në një nivel më të lartë.

16.57 Gjenerator saldimi

Çdo pajisje rrotulluese që prodhon një rryme elektrike për saldim.

17. DEKLARATA EC E KONFORMITETIT

Deklarata EC e konformitetit përmban informacionin e mëposhtëm:

- a) emrin dhe adresën e fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- b) emrin dhe adresën e personit që mban dokumentacionin teknik;
- c) përshkrimin e pajisjes;
- d) procedurën e kryer të vlerësimit të konformitetit, dhe kur është e nevojshme, emrin dhe adresën e organit të autorizuar/organizmit të notifikuar europian për kryerjen e vlerësimit të konformitetit (me poshtë “organizëm europian”);
- e) nivelin e matur të fuqisë së tingullit të një pajisjeje përfaqësuese për këtë tip;
- f) nivelin e garantuar të fuqisë së tingullit për këtë pajisje;
- g) një referencë për këtë rregull teknik;
- h) deklaratën se pajisja përputhet me kërkesat e këtij rregulli teknik;
- j) aty ku është e nevojshme, deklaratat/të konformitetit dhe referencat e rregullave teknikë të tjerë të zbatuar;
- k) vendin dhe datën e deklaratës;
- l) të dhënat e nënshkruesit të autorizuar që vepron në emër të fabrikuesit ose përfaqësuesit të tij të autorizuar.

18. METODA E MATJES SË ZHURMËS NË AJËR E METUAR NGA PAJISJET PËR PËRDORIM NË MJEDISE TË HAPURA

18.1. Metodat e matjeve të zhurmës në ajër që përdoren për përcaktimin e nivelit të fuqisë së tingullit për pajisjet që mbulohen nga ky rregull teknik, me qëllim kryerjen procedurave të vlerësimit të konformitetit.

18.2. Pika 19 e këtij rregulli teknik për çdo tip pajisjeje përcakton:

- a) standardet bazë të emetimit të zhurmës;
- b) shtesat e përgjithshme të këtyre standardeve bazë të emetimit të zhurmës për matjen e nivelit të presionit të tingullit mbi një sipërfaqe matjeje që rrethon burimin dhe për llogaritjen e fuqisë së nivelit të tingullit të prodhuar nga burimi.

18.3. Pika 20 e këtij rregulli teknik për çdo tip pajisjeje përcakton:

- a) një standard të rekomanduar bazë për emetimin e zhurmave të rekomanduar, përfshirë:
 - i) një referencë të standardeve bazë të emetimit të zhurmës zgjedhur nga pika 19;
 - ii) zonën e provës;
 - iii) vlerën e a konstantes K2A;
 - iv) formën e sipërfaqes të matjes;
 - v) numrin dhe pozicionin e mikrofonave që do të përdoren;
- b) kushtet e punës përfshirë:
 - i) referencën e një standardi, nëse ka;
 - ii) kërkesat në lidhje me montimin e pajisjeve;
 - iii) metoda e përdorur për të llogaritjen e rezultateve të niveleve të fuqisë së tingullit në rast se do të përdoren disa prova me kushte pune të ndryshme;
 - iv) informacione të mëtejshme.

18.4. Kur provohen tipa specifike të pajisjeve, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mund të zgjedhe një standard bazë të emetimit të zhurmave të pikës 19 dhe të zbatoje kushtet e punës të pikës 20 për këtë tip specifik pajisjeje. Megjithatë në rast mosmarrëveshjeje, standardi bazë i rekomanduar për emetimin e zhurmës i përcaktuara në pikën 20 duhet të përdoret së bashku me kushtet e punës të pikës 20.

19. STANDARDET BAZË TË EMETIMIT TË ZHURMËS

Për përcaktimin e nivelit të fuqisë së tingullit të pajisjeve për përdorim në mjedise të hapura në përgjithësi mund të përdoren standardet bazë të emetimit të zhurmave:

- SSH EN ISO 3744:2007;
- SSH EN ISO 3746:2010;

në përgjithësi mundet të përdoren duke pranuar shtesat e përgjithshme të mëposhtme.

19.1. Pasiguria e matjes

Pasiguria e matjes nuk është marrë parasysh në kuadër të procedurave të vlerësimit të konformitetit në fazën e projektimit.

19.2. Efekti i burimit gjatë provës

19.2.1. Shpejtësia e ventilatorit

Në qoftë se motori i pajisjes ose sistemi hidraulik i tij është i pajisur me një ose disa ventilatorë, ai/ata duhet të punojnë gjatë provës. Shpejtësia e ventilatorit është, në përputhje me një nga kushtet e mëposhtme, deklaruar dhe vendosur nga fabrikuesi i pajisjeve dhe duhet të paraqitet në raportin e provës, duke u përdorur kjo shpejtësi në matjet e mëtejshme:

a) transmensionin i ventilatorit i lidhur drejtpërsëdrejti me motorin

Nëse transmensionin i ventilatorit është e lidhur direkt me motorin dhe/ose pajisjen hidraulike (p.sh. rrip transmensionin) ai duhet të punojë gjatë provës.

b) transmensionin i ventilatorit me disa shpejtësi të ndryshme

Nëse ventilatori mund të punojë me disa shpejtësi të ndryshme prova do të kryhet:

- në shpejtësinë e saj maksimale të punës; ose

- në një provë të parë me ventilatorin vendosur në shpejtësi zero dhe në një provë të dytë ventilatori vendosur me shpejtësi maksimale. Niveli i presionit të tingullit të rezultuar L_{pA} të llogaritet duke i kombinuar të dyja rezultatet e provave duke përdorur ekuacionin e mëposhtëm:

$$L_{pA} = 10 \lg \{0,3 \times 10^{0,1L_{pA,0\%} + 0,7} \times 10^{0,1L_{pA,100\%}}\},$$

ku

$L_{pA, 0\%}$ është niveli i presionit të tingullit të përcaktuar me ventilator të vendosur në shpejtësi zero;

$L_{pA, 100\%}$ është niveli i presionit të tingullit të përcaktuar me ventilator të vendosur në shpejtësi maksimale.

c) Transmision ventilatori me shpejtësi vazhdimisht të ndryshueshme.

Nëse ventilatori mund të punojë me shpejtësi vazhdimisht të ndryshueshme, prova do të bëhet jashtë ose sipas 19.2.1 (b), ose me shpejtësinë e ventilatorit të vendosur nga fabrikuesi në jo më pak se 70% e shpejtësisë maksimale.

19.2.2. Prova e pajisjeve mundësuar pa ngarkesë

Për këto matje, motori dhe sistemi hidraulik i pajisjes duhet të jetë ngrohur në përputhje me udhëzimet/instrukSIONET, dhe duhet të respektohen kërkesat e sigurisë. Prova bëhet me pajisje në një pozicion të palëvizshëm, pa veprimin e pajisjes së punës ose mekanizmit udhëtues.

Për qëllimin e provës, motori do të punojë pa ngarkesë me jo më pak se shpejtësia përkatëse të vlerësuar që i korrespondon të fuqisë neto (*).

Fuqi neto do të thotë fuqia në kW (CE) e marrë në makinën e provës në fund të boshtit me gunga/kollodokut, ose ekuivalente e saj, e matur në përputhje me metodën EC të matjes të fuqisë së motorëve me djegie të brendshme për automjetet rrugore, përveçse fuqia e motorit të ventilatorit ftohës është përjashtuar.

Nëse makina është mundësuar nga një gjenerator apo nga rrjeta, frekuenca e furnizimit të rrymës, të specifikuar për motorin nga prodhuesi, duhet të jetë e qëndrueshme në $\pm$

1 Hz nëse makina është e pajisur me një motor me induksion, dhe tensioni i furnizimit me $\pm$ 1% të tensionit të vlerësuar, nëse makina është e pajisur me një komutator motori. Furnizimi me tension të matet në prizën e një kablllo jo të ndashme ose kordoni, ose në hyrje të makinës, nëse është parashikuar një kablllo e ndashme. Formë e rrymës e furnizimit të korrentit nga gjeneratori do të jetë e ngjashme me atë të marrë nga rrjeta.

Nëse makina punon me bateri, ajo duhet të jetë plotësisht e ngarkuar. Shpejtësia e përdorur dhe fuqia përkatëse neto janë deklaruar nga fabrikuesi i pajisjeve dhe duhet të paraqitet në raportin e provës.

Nëse pajisja është e pajisur me disa motorë, ata duhet të punojnë në të njëjtën kohë gjatë provave. Nëse kjo nuk është e mundur, do të provohet çdo kombinim i mundshëm i motorit(ëve).

19.2.3. Prova e pajisjes mundësuar me ngarkesë

Për këto matje, motori (pajisja lëvizëse) dhe sistemi hidraulik i pajisjeve duhet të jetë ngrohur në përputhje me udhëzimet, si dhe duhet të respektohen kërkesat e sigurisë. Asnjë pajisje sinjalizuese, siç janë ato me bori ose me sisteme alarmi sigurie, nuk duhet të funksionojë gjatë provës.

Shpejtësia ose ritmi i pajisjeve gjatë provës duhet të regjistrohen dhe të paraqiten në raportin e provës.

Nëse pajisja është e pajisur me disa motorë dhe/ose agregate, ata duhet të punojnë në të njëjtën kohë gjatë provave. Nëse kjo nuk është e mundur, do të provohet çdo kombinim i mundshëm i motorit(ëve) dhe/ose agregateve.

Për çdo tip pajisjeje që do të provohet me ngarkesë, kushtet specifike të punës duhet të jenë përcaktuara që në parim të prodhojnë efekte dhe strese të ngjashme me ato që hasen në kushtet aktuale të punës.

19.2.4. Prova e pajisjeve manuale

Kushtet konvencionale të punës për secilin tip të pajisjeve manuale përcaktohen që të prodhojnë efekte dhe strese të ngjashme me ato të pësura në kushtet aktuale të punës.

19.3. Llogaritja e nivelit sipërfaqësor të presionit të tingullit

Niveli sipërfaqësor i presionit të tingullit do të përcaktohet të paktën tre herë. Nëse të paktën dy nga vlerat e përcaktuara nuk ndryshojnë me më shumë se 1 dB, matjet e mëtejshme nuk do të jenë të nevojshme, përndryshe matjet do të vazhdojnë të merren deri në dy vlera të ndryshme nga jo më shumë se 1 dB. Niveli sipërfaqësor i presionit të tingullit të ponderuar A që do të përdoret për llogaritjen e nivelit të fuqisë së tingullit është mesatarja aritmetike të dy vlerave më të larta që nuk ndryshojnë me më shumë se 1 dB.

19.4. Informacioni që duhet raportuar

Niveli i fuqisë së tingullit të ponderuar A të burimit, i nënshtuar provës, duhet të raportohet me rrumbullakimin në numrin më të afërt (kur është më pak se 0,5 rrumbullakoset në numrin më të vogël; kur është më i madh se ose e barabartë me 0,5 rrumbullakoset në 1 numër më të madh). Raporti duhet të përmbajë të dhëna teknike të nevojshme për të identifikuar burimin e nënshtuar të provës, si dhe kodin e provës së zhurmës dhe të dhënat akustike.

19.5. Pozicione të tjera mikrofonash në sipërfaqen e matjes hemisferikale (SSH EN ISO 3744:2007)

Përveç dispozitave 7.2.1 dhe 7.2.2 të SSH EN ISO 3744:2007 mund të përdoren një komplet prej 12 mikrofonash në sipërfaqen e matjes hemisferike.

Vendosja e 12 pozicioneve të mikrofonave të shpërndarë në sipërfaqen e një hemisfere me rreze r janë të rreshtuara në formë të koordinatave karteziane në tabelën në vijim. Rrezja e hemisferës do të jetë e barabartë me/ose më e madhe se dyfishi i përmasës më të madhe të paralelepipedit të referencës. Paralelepipedi i referencës është përcaktuar si paralelepipedi më i vogël i mundshëm drejtkëndor që rrethon vetëm pajisjen (pa bashkëngjitur) duke u kufizuar me planin e pasqyrimin. Rrezja e hemisferës do të rrumbullakoset në vlerat më të afërta të larta të mëposhtme: 4, 10, 16 m.

Numri (12) i mikrofonave mund të reduktohet deri në gjashtë, por me pozicione mikrofoni 2, 4, 6, 8, 10 dhe 12 pas kërkesave të pikës 7.4.2 duhet të përdoret në çdo rast SSH EN ISO 3744:2007.

Në përgjithësi marrëveshja me gjashtë pozicione mikrofonash duhet të përdoret në një sipërfaqe të matjes hemisferike. Nëse ka specifikime të tjera të përcaktuara në një kod të provës së zhurmës në këtë rregull teknik për pajisje të veçanta, do të përdoren këto specifikime.

TABELA
KOORDINATAT E 12 POZICIONEVE TË MIKROFONAVE

Numri i mikrofonave	x/r	y/r	z
1	1	0	1,5m
2	0,7	0,7	1,5m
3	0	1	1,5m
4	-0,7	0,7	1,5m
5	-1	0	1,5m
6	-0,7	-0,7	1,5m
7	0	-1	1,5m
8	0,7	-0,7	1,5m
9	0,65	0,27	0,71r
10	-0,27	0,65	0,71r
11	-0,65	-0,27	0,71r
12	0,27	-0,65	0,71r


19.6. Korrigjim mjedisor K_{2A}

Pajisja do të matet në një sipërfaqe pasqyre betoni, ose asfalto-betoni joporoz, atëherë korrigjimi mjedisor është përcaktuar $K_{2A}=0$.

Nëse ka specifika të tjera të përcaktuara në një kod të provës së zhurmës të këtij udhëzimi për një pajisje të veçantë, do të përdoren këto specifika.

Figura

Rrjet mikrofonash shtesë në hemisferën (12 pozicione mikrofon)



20. KODET E PROVËS SË ZHURMËS PËR PAJISJE TË VEÇANTA

20.0. Pajisje që është testuar pa ngarkesë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007

Zona e provës

Sipërfaqe pasqyre/reflektuese e betonit ose e asfalt joporoz.

Korrigjimi i mjedisit K_{2A}

$K_{2A} = 0$.

Sipërfaqe matje/numri i pozicioneve të mikrofonave/matja e përmasave:

i) Në qoftë se përmasa më e madhe e paralelepipedit të referencës nuk kalon 8 m, hemisfere/gjashtë pozicione mikrofonit sipas pikës 19.5, sipas pikës 19.5;

ii) Nëse përmasa më e madhe e paralelepipedit të referencës kalon 8 m, paralelepipedit sipas SSH ISO 3744:2007 me distancën e matjes $d = 1$ m.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova pa ngarkesë

Provat e zhurmës do të kryhen në përputhje me pikën 7.2.2.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimit të nivelit të fuqisë së tingullit rezulton se është përdorur më shumë se një kusht pune.

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.1. Platformat ajrore me motor me djegie të brendshme:

shiko nr.20.0.

20.2. Furçë hapëse

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH EN ISO 22868:2009.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonave/matja e përmasave:

SSH EN ISO 22868:2009.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

SSH EN ISO 22868:2009, pika 5,3.

Periudha(t) e vëzhgimit

SSH EN ISO 22868:2009.

20.3. Pajisjet ngritëse në ndërtim për transportin e mallrave:

shiko nr.20.0.

Qendra gjeometrike e motorit do të vendoset mbi qendrën e hemisferës, pajisja ngritëse do të lëvizë pa ngarkesë dhe në hemisferën, nëse është e nevojshme, në drejtim të pikës 1.

20.4. Makinat sharrë shirit të kantierëve të ndërtimit

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 7960:2008, shtojcën J me $d = 1$ m.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Korrespondon vetëm SSH ISO 7960:2008, aneksi J (vetëm pika J2 (b)).

Periudha e vëzhgimit

Korrespondon SSH ISO 7960:2008, shtojca J.

20.5. Makinat sharrë rrethore të kantierëve të ndërtimit

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja matëse/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 7960:2008, shtojca A, matja e përmasave $d = 1$ m.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

SSH ISO 7960:2008, shtojca A (vetëm pika A.2.b)

Periudha e vëzhgimit

SSH ISO 7960:2008, shtojca A.

20.6. Sharrat zinxhir, portative

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH EN ISO 22868:2009.

Sipërfaqja matëse/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH EN ISO 22868:2009.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë/prova pa ngarkesë

Ngarkesë e plotë sharrim druri/ motori në rrotullim maksimal pa ngarkesë

a) motor me djegie të brendshme:

SSH EN ISO 22868:2009;

pikat 6,3 dhe 6,4.

b) motor elektrik: prova i korrespondon SSH EN ISO 22868:2009, pika 6,3 dhe një provë me rrotullime maksimale të motorit pa ngarkesë.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimit të nivelit të fuqisë së tingullit të rezultuar, nëse është përdorur më shumë se një kusht pune

SSH EN ISO 22868:2009 pikat 6,3 dhe 6,4.

Niveli i fuqisë së tingullit të rezultuar LWA llogaritet nga:

$$L_{WA} = 10 \lg \left[\frac{1}{2} \left(10^{0,1 L_{W1}} + 10^{0,1 L_{W2}} \right) \right],$$

ku LW1 dhe LW2 janë nivelet mesatare të fuqisë së tingullit të dy mënyrave të ndryshme të funksionimit të përcaktuara më sipër.

20.7. Larës të kombinuar me presion të lartë dhe automjete thithëse

Nëse është e mundur të veprojnë të dy pajisjet në të njëjtën kohe, kjo do të bëhet sipas nr.20.26 dhe 20.52. Nëse jo, ajo matet veçmas dhe konstatohen vlerat më të larta.

20.8. Makina ngjeshëse:

i) rule jovibruese, shiko nr.20.0;

ii) rule vibruese të drejtuar nga operatorë.

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Rul vibrues do të instalohet në një ose më shumë materiale të përshtatshme elastike, të tilla si jastëk ajri. Këto mbështetëse ajri do të bëhen nga materiale të përkulshme (elastike ose të ngjashme) dhe do të fryhen me një presion të sigurt që makina të jetë ngritur të paktën 5 cm: efektet e rezonancës duhet të shmangen. Përmasa e jastëkut(ëve) duhet të jetë/në e/të tillë që stabiliteti i makinës dhe prova të jenë të sigurt.

Prova me ngarkesë

Makina duhet të provohet në një pozicion të palëvizshëm me motor me shpejtësi të vlerësuar (e deklaruar nga prodhuesi) dhe me mekanizmat e lëvizshme të stakuar. Mekanizmi i ngjeshjes do të veprojë duke përdorur fuqinë maksimale ngjeshëse që korrespondon me kombinimin e frekuencës më të lartë dhe amplitude të lartë të mundshme për atë frekuencë që është deklaruar nga fabrikuesi.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë së paku 15 sekonda.

iii) Pllaka dridhëse, tokmakë dridhës, tokmakë shpërthyes dhe rule dridhëse me ecje prapa.

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

EN 500-4 rev. 1:1998, aneksi C.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

SSH EN 500-4 rev. 1:2010, aneksi C.

Periudha e vëzhgimit

SSH EN 500-4 rev. 1:2010, aneksi C.

20.9. Kompresorë

Standardet bazë për emetimin e zhurmave

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

Gjashtë pozicione mikrofonash/hemisfere sipas pikës 19.5, ose sipas paralelepipedit për SSH EN ISO 3744:2007 me përmasën e matjes $d = 1$ m.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Kompresorët do të instalohen në rrafsh pasqyrë: kompresorët e montuar në trung do të vendosen në një mbështetje 0,40 m të lartë, përveç rasteve kur kërkohet ndryshe në kushtet e instalimit të prodhuesit.

Prova me ngarkesë

Kompresori në provë do të jetë i ngrohur dhe të punojë në kushte të qëndrueshme, si për punë të vazhdueshme. Ai do të jetë i riparuar dhe lubrifikuar siç duhet dhe i përcaktuar nga fabrikuesi.

Përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit do të bëhet me ngarkesë të plotë, ose në kushte pune, që është riprodhim dhe përfaqësues i punës me zhurmë të përdorimit tipik të makinës në provë, cilido të jetë gjeneruesi i zhurmës.

Nëse vendosja e implantit komplet është e tillë që përbërësit e caktuar, p.sh. ndër freskuesit janë montuar larg kompresorit, përpjekjet duhet të bëhen për të ndarë zhurmat e gjeneruara nga pjesë të tilla për të kryer provën e zhurmës. Ndarja e burimeve të zhurmave të ndryshme mund të kërkojë pajisje për zbutjen e zhurmës nga këto burime gjatë matjes. Karakteristikat e zhurmës dhe përshkrimi i kushteve të punës të pjesëve të tilla do të jepet veçmas në raportin e provës.

Gjatë provës karburanti i zonës së provës i përdorur nga kompresori do të jetë i pastër.

Kujdes duhet bërë për të siguruar zhurmën e krijuar nga karburanti ekzistues i përdorur së paku 10 dB më i ulët se zhurma e matur në të gjitha pozicionet e matjes (p.sh. nga vendosja e një silenciatori).

Kujdes duhet bërë nga shkarkimet në ajër nga futja e ndonjë zhurme shtesë për shkak të turbullirave në valvulat e shkarkimit të kompresorit.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë së paku 15 sekonda.

20.10. Thyerës betoni dhe gërmues, mbajtës dore

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

Hemisferë/gjashtë pozicione të mikrofonit sipas pikës 19.5 dhe tabela e mëposhtme në vijim/sipas masave të pajisjeve, të dhëna në tabelën në vijim.

Masa e pajisjes m në kg	Rrezja e hemisferës	z për pozicionet e mikrofonit 2, 4, 6 dhe 8
$m < 10$	$m \geq 10$	0,75 m
$m \geq 10$	4 m	1,50 m

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Të gjitha pajisjet duhet të provohen në pozicion vertikal.

Nëse pajisja e provës është e pajisur me gyp të shkarkimit të ajrit, boshti i tij do të jetë i baraslarguar nga të dyja pozicionet e mikrofonave. Zhurma e furnizimit me energji elektrike nuk do të ndikojë matjen e zhurmës që emetohet nga pajisja e provës.

Mbështetja e pajisjes

Gjatë provës pajisja do të jetë e lidhur me një mjet të ngulitur në një bllok betoni në formë kubike të vendosur në një gropë betoni, zhytur në tokë.

Një pjesë e ndërmjetme prej çeliku mund të futet gjatë provave në mes të pajisjes dhe mjetit mbështetës, fig.10.1 përfshin këto kërkesa.

Karakteristikat e bllokut

Blloku duhet të jetë në formën e një kubi $0,60\text{ m} \pm 2\text{ mm}$ i gjatë, me buzë të rregullt dhe sa të jetë i mundur betoni duhet bërë i përforcuar dhe vibruar tërësisht në shtresat deri në 0,20 m, për të shmangur llumin e tepërt.

Cilësia e betonit

Cilësia e betonit duhet të korrespondojë me C 50/60 të ENV 206. Kubi do të përforcohet nga shufra çeliku me diametër 8 mm, pa lidhëse, ku secila shufër është e pavarur nga njëra-tjetra; koncepti i projektimit është ilustruar në figurën 10.2.

Mjeti mbështetës

Mjeti do të mbyllet në bllok dhe do të përbëhet nga një tokmak me diametër jo më pak se 178 mm dhe jo më shumë se 220 mm dhe një mjet nofull, komponent i njëjtë me atë që përdoret normalisht me pajisjen që testohet dhe në përputhshmëri me SSH ISO 1180:2008, por mjaftueshëmrisht i gjatë që të mundësojë kryerjen e provës praktike.

Trajtimi i përshtatshëm duhet të kryhet për të bërë një të tërë të dy komponentët.

Mjeti fiksohet në bllok në mënyrë që pjesa e poshtme e tokmakut të jetë 0,30 m nga pjesa e sipërme e bllokut (shih figurën 10.2).

Blloku duhet të mbetet mekanikisht i fortë, veçanërisht në pikën ku takohet mjeti mbështetës dhe betoni. Para dhe pas çdo prove do të përcaktohet që mjeti i mbyllur është bërë një i tërë me të në bllokun e betonit.

Pozicionimi i kubit

Kubi do të jetë vendosur në një gropë të çimentuar, mbuluar me një pllakë mbuluese, të paktën 100 kg/m^2 , siç tregohet në figurën 10.3, në mënyrë që sipërfaqja e sipërme e pllakës mbuluese të jetë në një nivel me tokën.

Për të shmangur ndonjë zhurmë parazite, blloku duhet izoluar kundrejt fundit dhe anëve të gropës nga blloqe elastike, frekuencat e ndërprerjeve të të cilave nuk do të jenë më shumë se gjysma e shkallës së goditjes së pajisjes së provës, e shprehur si goditje për sekondë. Hapja në pllakën mbrojtëse nëpër të cilën kalon komponenti nofull, duhet të jetë e vogël sa më shumë të jetë e mundur, si dhe e mbyllur nga një nyje elastike e papërshkueshme zëri.

Prova me ngarkesë

Pajisja nën provë duhet të lidhet me mjetin mbështetës.

Pajisja nën provë duhet të punojë në kushte të qëndrueshme që ka të njëjtën stabilitet akustik si në shërbimin normal.

Pajisja nën provë duhet të punojë me fuqinë maksimale të specifikuar në instruksionet e furnizuara të blerësit

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

Figura 10
Diagrami skematik i pjesës së ndërmjetme




Figura 10.2
Bllok prove





Figura 10.3
Pajisje prove



20.11. Betoniere ose përzierëse llaçi
Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës
Prova me ngarkesë

Pajisja përzierëse (tamburi) do të jetë e mbushur në kapacitetin e saj nominal me rërë të ashpër 0-3 mm dhe lagështia do të jetë 4 deri 10%.

Pajisja përzierëse do të punojë të paktën me shpejtësinë nominale.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë së paku 15 sekonda.

20.12. Çikrikë ndërtimi:

shiko nr.20.0.

Qendra gjeometrike e motorit do të vendoset mbi qendrën e hemisferës, çikriku do të jetë i lidhur, por nuk do të aplikohet me ngarkesë.

20.13. Makinat transportuese/mbartëse dhe sprucuese për beton dhe llaç

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Nëse makina është e pajisur me një krah, ky vendoset në pozicion vertikal dhe tubi drejtohet përsëri në hinkën mbushëse. Nëse nuk është ky rast, atëherë makina duhet të pajiset me një tub horizontal të paktën 30 m të gjatë që kthehet drejt hinkës mbushëse.

Prova me ngarkesë:

i) Për makina transportuese/mbartëse dhe sprusuese betoni:

Sistemi i transportimit/mbartës dhe tubi do të jenë të mbushur me një material të ngjashëm me betonin, çimentoja zëvendësohet nga një përzierje, p.sh. hirit të imët. Makina do të punojë në prodhimin e saj maksimal, me periudhë të një cikli pune jo më shumë se 5 sekonda (nëse kjo periudhë është tejkaluar, uji do të shtohet në “beton” në mënyrë që të arrijë këtë vlerë).

ii) Për makina transportuese/mbartëse dhe sprucuese llaçi:

Sistemi transportues/përcjellës dhe tubi do të jenë të mbushur me një të material të ngjashëm me llaçin e përfunduar, çimentoja zëvendësohet nga një përzierje, p.sh. celulozë metalike. Makina do të punojë në prodhimin e saj maksimal, me periudhë të një cikli pune jo më shumë se 5 sekonda (nëse kjo periudhë është tejkaluar, uji do të shtohet në “llaç” në mënyrë që të arrihet kjo vlerë).

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.14. Rripa transportues:
shiko nr.20.0.

Qendra gjeometrike e motorit do të vendoset mbi qendrën e hemisferës, rripi do të lëvizë pa ngarkesë dhe lë hemisferën, nëse është e nevojshme, në drejtim të pikës 1.

20.15. Pajisje ftohëse në automjete
Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës
Prova me ngarkesë

Pajisja e ftohjes duhet të jetë e instaluar në një hapësirë ngarkese të vërtetë ose artificiale dhe të provohet në një pozicion të palëvizshëm, ku lartësia e pajisjes së ftohjes duhet të jetë përfaqësuese e kërkesave të instalimit, sipas udhëzimeve të ofruara për blerësin. Burimi i energjisë i pajisjeve të ftohjes duhet të punojë në shkallën që shkakton shpejtësinë maksimale të kompresorit ftohës dhe të ventilatorit të specifikuar në instruksionet. Nëse pajisja e ftohjes është e parashikuar të marrë energji nga motori i automjetit, motori nuk duhet të përdoret gjatë provës dhe pajisja e ftohjes duhet të lidhet me një burim të përshtatshëm të energjisë elektrike.

Njësitë e heqshme të traktorit duhet të hiqen gjatë provës.

Pajisja e ftohjes e instaluar në hapësirë-ngarkesën e njësive ftohëse, të cilat kanë zgjedhje të ndryshme të burimeve të energjisë, duhet të provohen veçmas për secilin burim të energjisë. Rezultati i provës së raportuar si minimum do të pasqyrojë mënyrën e punës, e cila çon në gjenerimin e zhurmës maksimale.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të paktën të jetë 15 sekonda

20.16. Buldozerë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 6395: 2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Buldozerët rrëshqitës do të provohen në vendin e provës të kantierit të ndërtimit që korrespondon me pikën 6.3.3 të SSH ISO 6395:2008.

Prova me ngarkesë

SSH ISO 6395:2008, shtojca B

Periudha(t) e vëzhgimit dhe shqyrtimi i kushteve të ndryshme të punës, nëse ndonjë SSH ISO 6395:2008, shtojca B.

20.17. Pajisjet shpuese

Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

SSH EN 791:2010, shtojca A.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të paktën të jetë 15 sekonda.

20.18. SHKARKUES

Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 6395: 2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Ekuivalenti SSH ISO 6395 :2008, aneksi C, me ndryshimin e mëposhtëm: C 4,3, paragrafi i dytë zëvendësohet “Motori do të punojë me shpejtësinë maksimale të drejtimit të saj (pa ngarkesë).

Kontrolli i transmetimit do të jetë vendosur në neutrale. Sillet kova në pozicionin e zbrazjes deri në rreth 75% të lëvizjes maksimale të saj dhe kthehet në pozicionin e saj lëvizës tre herë. Kjo sekuençë e ngjarjeve konsiderohet të jetë një cikël i vetëm për mënyrën e palëvizshme hidraulike. Nëse fuqia e motorit nuk është përdorur për këtë tip kove, motori do të punojë në shpejtësi bosh me transmetimin në neutral. Matja do të kryhet pa zbrazjen e kovës, periudha e vëzhgimit do të jetë 15 sekonda.”.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune

SSH ISO 6395:2008, aneksi C.

20.19. Pajisje për ngarkimin dhe shkarkimin e cisternave ose siloset në kamionë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Pajisja do të provohet me kamionin në një pozicion të palëvizshëm. Motori që vë në lëvizje pajisjen do të punojë me shpejtësi që shkakton prodhimin maksimal të pajisjes, e përcaktuar në udhëzimet për blerësin.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.20. Ekskavatorë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 6395:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

SSH ISO 6395:2008, shtojca A.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit i fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune

SSH ISO 6395:2008, shtojca A.

20.21. Ngarkues ekskavatorë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 6395:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

SSH ISO 6395:2008, shtojca D.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune

SSH ISO 6395:2008, shtojca D.

20.22. Kontejnerë të riciklimit të qelqit

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Për qëllim të këtij kodi të provës niveli i presionit të tingullit në një rast të vetëm L_{pl}s, siç përcaktohet në SSH EN ISO 3744:2007, pika 3.2.2, përdoret në matjen e nivelit të presionit të tingullit në pozicionet e mikrofonit.

Korrigjimi i mjedisit K_{2A}

Matja në pamje të hapur K_{2A} = 0.

Matjet në hyrje

Vlera e konstantes K_{2A}, e përcaktuar në përputhje me aneksin A të SSH EN ISO 3744:2007, do të jetë $\leq 2,0$ dB në të cilin rast K_{2A} do të merret parasysht.

Kushtet e punës gjatë provës

Matja zhurmës do të kryhet gjatë një cikli të plotë duke filluar me kontejner bosh dhe përfundon kur janë hedhur 120 shishe në kontejner.

Shishet e qelqit përcaktohen si më poshtë:

- Kapaciteti: 75 cl;

- Masë: 370 ± 30 g.

Operatori që kryen provën mban çdo shishe nga qafa e saj dhe me fundin e saj drejt vrimës së mbushjes dhe pastaj ai e shtyn atë butësisht brenda përmes vrimës mbushëse në drejtim të qendrës të kontejnerit, duke shmangur nëse është e mundur goditjen e shisheve kundrejt mureve. Vetëm një vrimë përdoret për hedhjen e shisheve dhe është ai më afër pozicionit 12 të mikrofonit.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune.

Niveli A i ponderuar i presionit të tingullit në një rast të vetëm është më mirë të matet njëkohësisht në gjashtë pozicione mikrofoni për çdo shishe të hedhur në enë

Niveli A i ponderuar i fuqisë së tingullit në një rast të vetëm mbi sipërfaqen e matjes, llogaritet sipas SSH EN ISO 3744: 2007, pika 8,1.

Niveli A i ponderuar i presionit të tingullit në një rast të vetëm, për të gjitha 120 shishet e hedhura llogaritet si mesatare logaritmike e niveleve mesatare A të ponderuara të rasteve të veçanta të nivelit të presionit të tingullit mbi sipërfaqen e matjes.

20.23. Nivelues

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave:

SSH ISO 6395:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

korrespondon me SSH ISO 6395:2008, shtojca B.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë rezultuese të tingullit në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune

SSH ISO 6395:2008, shtojca B.

20.24. Prerëset e barit/prerëse bari me tehe:

shih nr.20.2.

Makina prerëse do të vendoset me një pajisje të përshtatshme në mënyrë të tillë që pajisja prerëse e saj të jetë sipër/mbi qendrës të hemisferës. Për prerëset e barit, qendra e pajisjes së prerjes duhet të mbahet në një distancë prej rreth 50 mm më lart sipërfaqes. Në mënyrë që të akomodohen thikat prerëse, prerësja e barit me tehe duhet të vendoset sa më afër sipërfaqes së provës

20.25. Kositës gardhi

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007

Zona e provës

SSH ISO 11094:2008

Në raste të dyshimta, matjet do të kryhen në pamje të hapur në sipërfaqe artificiale (pika 4.1.2 e SSH ISO 11094:2008).

Korrigjimi i mjedisit K2A

Matja në mjedis të hapur

$K2A = 0$.

Matje në hyrje

Vlera e konstantes K2A, e përcaktuar pa sipërfaqen artificiale dhe në përputhje me aneksin A për SSH EN ISO 3744:2007, duhet të jetë $\leq 2,0$ dB, ku në secilin rast K2A merret parasysh

Sipërfaqja e matjes/ numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 11094:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Makina prerëse e shkurreve/gardh shkurresh, do të mbahet në mënyrë të natyrshme për përdorim normal ose nga një person, ose nga një pajisje e përshtatshme, në mënyrë të tillë që pajisja e saj prerëse të jetë më lart qendrës së hemisferës.

Prova me ngarkesë

Gërshëra e shkurreve, duhet të punojë me shpejtësinë e saj nominale me pajisjen prerëse të punës.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.26. Larës (shpëlarës) me presion të lartë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Larësi me presion të lartë duhet të provohet në gjendje stacionare. Motori dhe njësitë ndihmëse punojnë me shpejtësinë e ofruar nga fabrikuesi për funksionimin e pajisjeve të punës; pompa(t) e presionit të lartë punon(jnë) me shpejtësinë maksimale të tyre dhe presionin maksimal të punës së dhënë nga fabrikuesi.

Duke përdorur një pajisje mekanike/tub të përshtatshëm, valvula e reduktimit të presionit duhet të jetë pikërisht në pikën të kundërveprimit. Zhurma rrjedhëse e pipëzës nuk duhet të ketë asnjë ndikim mbi rezultatet e matjeve.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 30 sekonda.

20.27. Makina uji të presionit të lartë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave:

Paralelepiped/sipas SSH EN ISO 3744:2007 me distancën e matjes $d = 1$ m.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Makina e presionit të lartë të ujit duhet të jetë e instaluar në rrafsh reflektuese; makina e montuar në trung do të vendoset në një mbështetje 0,40 m të lartë, përveç nëse kërkohet ndryshe në kushtet e instalimit të fabrikuesit.

Prova me ngarkesë

Makina e pastrimit të presionit të lartë do të sillet në gjendjen e saj të qëndrueshme brenda intervalit të specifikuar nga fabrikuesi. Gjatë provës pajisja mekanike/tub etj. do të jetë e lidhur me makinën e pastrimit të presionit të lartë që shkakton presionin më të lartë, nëse përdoret në përputhje me udhëzimet e fabrikuesit.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.28. Çekan hidraulik

Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/ matja e përmasave:
hemisfera/gjashtë pozicionesh mikrofoni sipas pikës $19.5 \text{ } 5/r = 10 \text{ m}$.

Kushtet e punës gjatë provave

Montimi i pajisjeve

Për provën, çekani është bashkangjitur në një mbajtëse dhe do të përdoret një strukturë bllok të veçantë prove. Figura 28.1 jep karakteristikat e kësaj strukture dhe figura 28.2 tregon pozicionin e mbajtëses.

Mbajtësi

Mbajtësi i çekanit të provës duhet të plotësojë kërkesat e specifikimeve teknike të çekanit të provës, veçanërisht në kufijtë e peshës, fuqisë së rendimentit hidraulik, presionit të furnizimit të rrjedhjes së vajit, si dhe të kthimit mbrapa.

Montimi

Montimi (instalimi) mekanik, si dhe lidhjet (markucet, tubat...) duhet të korrespondojnë me specifikat e dhëna në të dhënat teknike të çekanit. Duhet të eliminohen të gjitha zhurmat e rëndësishme të shkaktuara nga tubat dhe komponentët e ndryshëm mekanikë të nevojshëm për instalimin. Të gjitha lidhjet e komponentëve duhet të jenë të forcuara.

Stabiliteti i çekanit dhe fuqia mbajtëse statike

Çekani do të mbahet në mënyrë të vendosur poshtë nga mbajtësja në mënyrë që të japë të njëjtin stabilitet me atë ekzistues në përputhje me kushtet normale të punës. Çekani duhet të punojë në pozicion vertikal.

Mjeti

Një mjet i pamprehur (pa majë) duhet të përdoret për matje. Gjatësia e mjetit duhet të plotësojë kërkesat e dhëna në figurën 28.1 (blloku i provës).

Prova me ngarkesë

Fuqia e shpenzuar hidraulike dhe rrjedhja e vajit

Kushtet e punës së çekanit hidraulik duhet të rregullohen, matur dhe raportuar si duhet së bashku me vlerat përkatëse të specifikimeve teknike. Çekani në provë duhet të përdoret në mënyrë të tillë që të mund të arrihet 90% ose më shumë e energjisë maksimale hidraulike të shpenzuar dhe rrjedhjes së vajit të çekanit.

Kujdes duhet të bëhet që pasiguria totale e vargut të matjes të ps dhe Q të mbahet brenda $\pm 5\%$. Kjo siguron fuqi hidraulike të hyrjes të përcaktuar me saktësi $\pm 10\%$. Duke supozuar korrelacion linear ndërmjet energjisë hidraulike të hyrjes dhe fuqisë së tingullit të lëshuar/emetuar, kjo do të thotë ndryshim i më pak se $\pm 0,4 \text{ dB}$ në përcaktimin e nivelit të fuqisë të tingullit.

Komponentët e rregullueshëm kanë efekt në fuqinë e çekanit.

Regjistrimi paraprak i parametrave të të gjithë akumulatorëve, valvulat qendrore të presionit dhe komponentët tjerë të mundshëm të rregullueshëm duhet të bëhet sipas vlerave përkatëse të të dhënave teknike. Nëse më shumë se një parametër i caktuar është jodetyrues, matjet duhet të realizohen duke përdorur të gjitha parametrat. Në këtë rast paraqiten vlerat minimale dhe maksimale.

Sasitë që do të maten:

- ps do të thotë vlera e presionit të vogël hidraulik të furnizimit gjatë funksionimit të çekanit duke përfshirë së paku 10 rrahje;

- Q do të thotë vlera e rrjedhjes të vajit në grykën hyrëse të matur njëherësh me ps; \

- T, temperatura e vajit duhet të jetë ndërmjet $+ 40/+ 60^{\circ}\text{C}$ gjatë matjeve. Temperatura e pjesës hidraulike hyrëse duhet të jetë e stabilizuar në temperaturën normale përpara fillimit të matjeve;

- Pa, presionet e vajit para mbushjes së gjithë akumulatorëve duhet të maten në një situatë statike (hyrjet nuk punojnë) në temperaturë të qëndrueshme të ambientit ndërmjet $+ 15/+ 25^{\circ}\text{C}$. Temperatura e matur e ambientit duhet të regjistrohet me presionin e karburantit para mbushjes së akumulatorit.

Parametrat që vlerësohen nga parametrat e matur të punës janë:

- P_{in} , fuqi hidraulike hyrëse e çelësit të sigurisë

$$P_{in} = P_s \cdot Q$$

Madhësia e presionit hidraulik të linjës së furnizimit p_s :

- p_s duhet të matet sa më afër çelësit, nëse është e mundur në pikën e hyrjes;

- p_s duhet të matet me një matës presioni (diametri minimal: 100 mm; klasë saktësisë $\pm 1,0\%$ FSO);

Rrjedhja e vajit në hyrje të çelësit Q :

- Q duhet të matet nga linja e presionit të furnizimit sa më afër çelësit, dhe po të jetë e mundur në pikën e hyrjes;

- Q duhet të matet me një matës elektrik të rrjedhjes (klasa e saktësisë e leximit të rrjedhës $\pm 2,5\%$).

Pika e matjes të temperaturës së vajit T :

- T , duhet të matet nga rezervuari i transportimit të naftës ose nga linja hidraulike e lidhur me çekanin. Pika e matjes duhet të specifikohet në raport;

- Saktësia e leximit të temperaturës duhet të qëndrojë brenda $\pm 2^\circ\text{C}$ e vlerës aktuale.

Periudha e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit të rezultuar: periudha e vëzhgimit duhet të jetë së paku 15 sekonda.

Matjet përsëriten tre herë ose më shumë nëse është e nevojshme. Rezultati përfundimtar llogaritet si mesatare aritmetike e vlerave më të larta që nuk ndryshojnë më shumë se 1dB.

Figura 28.1





Figura 28.2



Përcaktime:

d diametri i mjetit (mm);

d_1 diametri i kudhrës, $1\,200 \pm 100$ mm;

d_2 diametri i brendshëm mbështetëses së kudhrës $\leq 1\,800$ mm;

d_3 diametri i pjesës së jashtme të bllokut të provës $\leq 2\,200$ mm;

d_4 diametri i hyrjes së mjetit në pjesën e jashtme të bllokut ≤ 350 mm;

d_5 diametri i mjetit të provës $\leq 1\,000$ mm;

h_1 gjatësia e dukshme e mjetit midis pjesës më të ulët të mjetit provë dhe sipërfaqes të sipërme (mm) $h_1 = d \pm d/2$;

h_2 trashësia e mjetit të provës mbi pjesën e jashtme të bllokut ≤ 20 mm (në qoftë se mjeti provës ndodhet nën kuvertë, trashësia e saj nuk është e kufizuar, por mund të jetë bërë prej shkume gome);

h_3 largësia midis sipërfaqes së sipërme të urës dhe sipërfaqes së sipërme të kudhrës 250 ± 50 mm;

h_4 trashësia e shkumës izoluese prej gome ≤ 30 mm;

h_5 trashësia e kudhrës 350 ± 50 mm;

h_6 thellësia e depërtimit të mjetit ≤ 50 mm;

Nëse struktura e përdorur e bllokut të provës është në formë katrore, përmasa e gjatësisë maksimale është e barabartë me $0,89 \times$ diametrin përkatës.

Hapësira boshe në mes të dyshemesë/pjesës së sipërme të bllokut dhe kudhrës mund të jetë e mbushur me shkumë gome elastike ose materiale të tjera thithëse, densiteti < 220 kg/m³ dhe diametri i mjetit (mm).

d_1 diametri i kudhrës $1\,200 \pm 100$ mm;

d_2 diametri i brendshëm i mbështetëses së kudhrës $\leq 1\,800$ mm;

d_3 diametri i urës bllok të provës $\leq 2\,200$ mm;

d_4 diametri i hapjes të mjetit në urë ≤ 350 mm;

d_5 diametri i mjetit të provës $\leq 1\,000$ mm;

h_1 gjatësia e dukshme e mjetit midis pjesës më të ulët të mjetit provë dhe sipërfaqes së sipërme (mm) $h_1 = d \pm d/2$;

h_2 trashësia e mjetit provë mbi urë ≤ 20 mm (në qoftë se mjeti provë ndodhet nën kuvertë, trashësia e saj nuk është e kufizuar, por mund të jetë bërë prej shkume gome);

h_3 largësia midis sipërfaqes së sipërme të urës dhe sipërfaqes së sipërme të kudhrës 250 ± 50 mm;

h_4 shkumë izoluese gome ngjitur në dysheme trashësi ≤ 30 mm;

h_5 trashësi e kudhrës 350 ± 50 mm;

h_6 thellësia e depërtimit të mjetit ≤ 50 mm;

Nëse struktura e përdorur e bllokut të provës është në formë katrore, përmasa e gjatësisë maksimale është e barabartë me $0,89 \times$ diametrin përkatës.

Hapësirë boshe në mes të dyshemesë dhe kudhrës mund të jetë e mbushur me shkumë gome elastike ose materiale të tjera thithëse, densiteti $< 220 \text{ kg/m}^3$.

20.29. Pajisjet presuese hidraulike

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Pajisja e fuqisë hidraulike instalohet në një plan të rrafshët reflektues; pajisja e fuqisë hidraulike e montuar në një platformë të lëvizshme do të vendoset në një mbështetëse 0,40 m të lartë, përveçse nëse kërkohet ndryshe nga fabrikuesi në kushtet e instalimit.

Prova me ngarkesë

Gjatë provës, pajisja e fuqisë hidraulike nuk do të lidhet me mjete të tjera. Pajisja e fuqisë hidraulike do të sillet përsëri në gjendjen e qëndrueshme brenda intervalit të specifikuar nga fabrikuesi. Ajo duhet të punojë me shpejtësinë dhe presionin e saj nominal.

Shpejtësia dhe presioni nominal janë ato të paraqitura në udhëzimet e furnizuesit për blerësin.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.30. Grirëse të përbashkëta

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Grirësja e përbashkët pajiset me thikën më të madhe të mundshme të parashikuar nga fabrikuesi në udhëzimet e furnizuesit për blerësin. Motori duhet të punojë me shpejtësinë e tij maksimale me thikë të ndaluar.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë së paku 15 sekonda.

20.31. Ngjeshësit në vendgroposje:

shiko nr.20.37.

20.32. Makinë kositëse bari

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 11094:2008.

Në rast mosmarrëveshjeje, matjet do të kryhen në ajër të lirë/të hapur mbi sipërfaqe artificiale (pika 4.1.2 e SSH ISO 11094:2008).

Korrigjim mjedisi K2A

Matja në mjedis të hapur

$K2A = 0$.

Matje në hyrje

Vlera e konstantes K2A, e përcaktuar pa sipërfaqen artificiale dhe në përputhje me aneksin A SSH EN ISO 3744:2007 të jetë $\leq 2,0 \text{ dB}$, në këtë rast K2A do të merret parasysht.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave:

SSH ISO 11094:2008 Kushtet e punës gjatë provës.

Montimi i pajisjeve

Nëse rrotat e kositësit të barit mund të shkaktojnë një ngjeshje të sipërfaqes artificiale prej më shumë se 1 cm, rrotat duhet të vendosen në mbështetëse në mënyrë që ajo të jetë në nivel me sipërfaqen artificiale para ngjeshjes. Nëse pajisja prerëse nuk mund të ndahet nga rrotat lëvizëse të kositëses së barit, kositësi do të provohet mbi mbështetëse me pajisjen prerëse që punon me shpejtësinë maksimale të përcaktuar nga fabrikuesi. Mbështetëset do të bëhen në mënyrë të tillë që ato të mos ndikojnë në rezultatet e matjes.

Prova pa ngarkesë

SSH ISO 11094:2008.

Periudha e vëzhgimit

SSH ISO 11094:2008.

20.33. Kositëse lëndinë/kositës anësor lëndine:

shiko nr.20.32.

Kositësi do të vendoset nga një pajisje e përshtatshme në mënyrë të tillë që pajisja prerëse e saj të jetë sipër qendrës së hemisferës. Për kositësit e lëndinës, qendra e pajisjes prerëse duhet të mbahet në një distancë prej rreth 50 mm mbi sipërfaqe. Në mënyrë që të përshtatet thikat e prerjes, kositësi i anës së lëndinës duhet të vendoset sa më afër në sipërfaqen e provës.

20.34. Ventilatorë gjethesh

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 11094:2008.

Në rast mosmarrëveshje, matja do të kryhet në ajër të hapur mbi sipërfaqe artificiale (pika

4.1.2 e SSH ISO 11094: 2008).

Korrigjimi i mjedisit K2A

Matja në ajër të hapur

$K2A = 0$.

Matja në hyrje

Vlera e konstantes K2A, e përcaktuar pa sipërfaqen artificiale dhe në përputhje me aneksin A të SSH EN ISO 3744:2007, do të jetë $\leq 2,0$ dB: në këtë rast K2A duhet të merret parasysh.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

SSH ISO 11094:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Ventilatori i gjetheve do të jetë i pozicionuar në mënyrë të natyrshme për përdorim normal në një mënyrë të tillë që dalja e pajisjes fryrëse e saj të jetë vendosur (50 ± 25 mm) mbi qendrën e hemisferës, e nëse është ventilator dore, ai duhet të mbahet nga një person ose nga një pajisje e përshtatshme.

Prova me ngarkesë

Ventilatori i gjetheve do të punojë me shpejtësinë dhe rrjedhjen e saj nominale të ajrit të deklaruar nga fabrikuesi.

Periudha e vëzhgimit.

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

Shënim. Në qoftë se një ventilator gjethesh mund të përdoret edhe si një kolektor gjethesh, ai duhet të provohet në dy konfigurime, në cilindro rast të përdoret vlera më e lartë.

20.35. Kolektorë gjethesh

Standardet bazë të emetimit të zhurmës.

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 11094:2008.

Në rast mosmarrëveshjeje, matja do të kryhet në ajër të hapur në sipërfaqe artificiale (pika 4.1.2 e SSH ISO 11094:2008).

Korrigjim mjedisi K2A

Matja në mjedis të hapur $K2A = 0$.

20.36. Kamionë ngritës

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Duhet të zbatohen kërkesat e sigurisë dhe informacionet e fabrikuesit.

Kushtet e ngritjes

Me kamion të palëvizshëm ngarkesa (material joabsorbues zhurme, p.sh. çelik ose beton, me të paktën 70% të kapacitetit aktual të përcaktuar në udhëzimin e fabrikuesit) duhet të ngrihet nga pozicioni më i ulët, me shpejtësinë maksimale në lartësinë standarde të ngritjes së aplikueshme për atë lloj kamioni industrial në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare në serinë “Siguria e kamionëve industrialë”. Nëse lartësia aktuale maksimale e ngritjes është më e vogël, mund të përdoret në matjet individuale. Lartësia e ngritjes do të jetë e shënuar në raportin e provës.

Kushtet e lëvizjes (ngarjes)

Lëvizja e kamionit, pa ngarkesë, në përshpejtimin e plotë nga qëndrimi në vend në një distancë prej tre herësh gjatësinë e saj për të arritur linjën A-A (linjë që lidh pozicionin 4 dhe 6 të mikrofonit) kamioni vazhdon lëvizjen me përshpejtimin maksimal në linjën B-B (linjë që lidh pozicionin 2 dhe 8 të mikrofonit).

Kur pjesa e pasme e kamionit ka kaluar linjën B-B, përshpejtuesit mund të çlirohen. Nëse kamioni ka një transimion me shumë marsha, zgjidhet marshi që siguron shpejtësinë më të lartë të mundshme përgjatë ë distancës së matjes

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi nivelit të fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune

Periudhat e vëzhgimit janë:

- Për kushtet e ngritjes: cikli i plotë i ngritjes;
- Për kushtet e lëvizjes: periudha kohore fillon kur qendra e kamionit kalon linjën A-A dhe mbaron kur ai qendra e tij arrin linjën B-B.

Niveli i fuqisë së tingullit të rezultuar për të gjitha llojet e kamionëve ngritës, llogaritet nga $LWA = 10 \log(0,7 \times 100,1LWAc \times 100,1LWAA)$, ku germa “a” tregon “mënyrën e ngritjes” dhe germa “c” tregon mënyrën e udhëtimit, ngarjes.

20.37. Ngarkuesit

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Matja e sipërfaqes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave
SSH ISO 6395:2008

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Makineria ngarkuese me sistem rrëshqitës/jo me rrota do të provohet në vendin e provës që korrespondon me pikën 6.3.3 të SSH ISO 6395:2008.

Prova me ngarkesë

SSH ISO 6395:2008, aneksi C.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi e nivelit të fuqisë së tingullit të rezultuar, në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune

SSH ISO 6395:2008, aneksi C.

20.38. Vinça lëvizës

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Nëse vinçi është i pajisur me krahë, ato duhet të shtrihen plotësisht dhe vinçi do të baraspeshojë mbi jastëkët e tij në pozicionin e mesit të mundshëm të lartësisë mbështetëse.

Prova me ngarkesë

Vinçi lëvizës për t’u provuar, do të paraqitet në versionin e tij standard, siç përshkruhet nga fabrikuesi. Fuqia motorike e parashikuar për përcaktimin e limitit të zhurmës është fuqia nominale e motorit e përdorur për lëvizjen e vinçit.

Vinçi do të pajiset me kundërpeshat e tij maksimale të lejuara të montuara mbi strukturën rrotulluese.

Para kryerjes të çdo matjeje, motori dhe sistemi hidraulik i vinçit lëvizës do të sillet në temperaturën normale të tij të punës, sipas udhëzimeve të fabrikuesit dhe procedurave përkatëse në lidhje me sigurinë, që jepen në librin e instruksioneve.

Nëse vinçi lëvizës është e pajisur me disa motorë, motori i përdorur për funksionin e vinçit duhet të punojë. Në këtë rast motori i transportit duhet të jetë i fikur.

Në qoftë se motori i vinçit lëvizës është i pajisur me një ventilator, ai duhet të punojë gjatë provës. Nëse ventilatori punon me shpejtësi të ndryshme, prova duhet të kryhet me ventilatorin në shpejtësinë më të lartë.

Vinçi lëvizës me krah do të matet në këto tri kushte të mëposhtme (a) deri në (c) ose në katër kushte (a) deri (d).

Për të gjitha kushtet e punës në vijim do të zbatohen:

- Shpejtësia e motorit me $\frac{3}{4}$ e shpejtësisë maksimale të specifikuar për mënyrën e punës të vinçit me një tolerancë prej $\pm 2\%$;

- Përsheptimi dhe ngadalësimi në vlerat maksimale pa lëvizje të rrezikshme të ngarkesës ose bllokun e fiksuar;

- Lëvizjet në shpejtësinë maksimale të mundshme sipas manualit të instruksioneve në kushtet e dhëna.

a) Ngritja

Vinçi lëvizës do të ngarkohet me një peshë që krijon 50% të forcës maksimale të litarit. Prova konsiston në ngritjen e ngarkesës që pasohet menjëherë me uljen në pozicionin e fillimit. Gjatësia e krahut do të zgjidhet në mënyrë që prova e plotë të zgjasë 15-20 sekonda.

b) Kthimi

Me krahun të rregulluar/përshtatur në një kënd prej 40° deri në 50° me planin horizontal dhe pa ngarkesë, karroca e sipërme duhet të kthehet 90° në të majtë të ndjekur menjëherë nga kthimi mbrapa në pozicionin e fillimit. Krah i vinçit do të jetë në gjatësinë e tij minimale. Periudha e vëzhgimit do të jetë koha e nevojshme për të kryer ciklin e punës.

c) Vinçimi

Prova fillon me ngritjen e krahut të shkurtër të vinçit nga pozicioni më i ulët i punës që pasohet menjëherë me ulje në krahut të vinçit në pozicionin e tij origjinal.

Lëvizja do të ekzekutohet pa ngarkesë. Kohëzgjatja e provës do të jetë të paktën 20 sekonda.

d) Teleskopimi (nëse aplikohet)

Me krah të vinçit të rregulluar në një kënd prej 40° deri në 50° me planin horizontal, pa ngarkesë dhe krah të vinçit plotësisht të tërhequr, cilindri teleskopik, për pjesën e parë vetëm do të shtrihet bashkë me pjesën e parë në gjatësinë të plotë të tij dhe menjëherë tërhiqet së bashku me pjesën e parë.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktim i nivelit të fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune.

Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit llogaritet nga:

i) kur është i pajisur me teleskop:

$$L_{WA} = \log (0,4 \times 10^{0,1L_{WAa}} + 0,25 \times 10^{0,1L_{WAb}} + 0,25 \times 10^{0,1L_{WAc}} + 0,1 \times 10^{0,1L_{WAd}});$$

ii) kur nuk është i pajisur me teleskop:

$$L_{WA} = \log (0,4 \times 10^{0,1L_{WAa}} + 0,3 \times 10^{0,1L_{WAb}} + 0,3 \times 10^{0,1L_{WAc}});$$

L_{WAa} është niveli i fuqisë së tingullit për ciklin e ngritjes;

L_{WAb} është niveli i fuqisë së tingullit për ciklin e kthimit;

L_{WAc} është niveli i fuqisë së tingullit për ciklin e linçimit;

L_{WAd} është niveli i fuqisë së tingullit për ciklin e teleskopimit (nëse aplikohet).

20.39. Kontejnerë të lëvizshëm të mbeturinave

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës:

- Sipërfaqe/plan e shndritshme e rrafshet betoni ose asfalti joporoz;
- Dhomë laboratorike e cila siguron një fushë të lirë në lidhje me planin e rrafshët pasqyruar.

Korrigjimi i mjedisit K2A

Matja në mjedis të hapur $K2A = 0$.

Matja në hyrje

Vlera e konstantes K2A, e përcaktuar në përputhje me aneksin A të SSH EN ISO 3744:2007, duhet të jetë $\leq 2,0$ dB, ku K2A duhet të merret parasysht.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

Hemisferë/gjashtë pozicione të mikrofonit sipas pjesës A pika 5/r = 3 m

Kushtet e punës gjatë provës

Të gjitha matjet do të kryhen me një kontejner bosh.

Prova nr.1: Mbyllje e lirë e kapakut përgjatë trupit të kontejnerit.

Për të minimizuar ndikimin e tij mbi matjet, operatori do të qëndrojë në anën e pasme të kontejnerit (varet me mentesha anash). Kapaku do të çlirohet nga mesi i tij, për të parandaluar rënien e tij gjatë përkuljes.

Matja do të bëhet gjatë ciklit të mëposhtëm, të përsëritur 20 herë:

- Fillimisht, kapaku është i ngritur vertikalisht;
- Kapaku është lëshuar përpara, nëse është e mundur pa i dhënë asnjë impuls, me operatorin në fund të kontejnerit, të palëvizur deri sa kapaku të jetë mbyllur;
- Pas mbylljes së plotë, kapaku është i ngritur në pozicionin e tij fillestar.

Shënim. Nëse është e nevojshme operatori mund të lëvizë përkohësisht për të ngritur kapakun.

Prova nr.2: Hapja e plotë e kapakut

Për të minimizuar ndikimin e tij mbi matjet, operatori do të qëndrojë në anën e pasme të kontejnerit (i varur me mentesha anash), për kontejnerët me katër rrota, ose në anën e djathtë të kontejnerit (midis pozicionit të 10 të mikrofonit dhe pozicionit të 12 të mikrofonit) për kontejnerët me dy rrota.

Kapaku do të çlirohet nga mesi e tij apo sa më afër që të jetë e mundur në mes të tij. Për të parandaluar çdo lëvizje të kontejnerit, rrotat duhet të jenë të bllokuara gjatë provës. Për kontejnerët me dy rrota, si dhe për të parandaluar çdo kërcim të kontejnerit, operatori mund ta mbajë atë duke e vendosur dorën e tij lart në skaj.

Matja kryhet gjatë ciklit të mëposhtëm:

- fillimisht, kapaku është i hapur horizontalisht;
- kapaku është i lëshuar pa i dhënë impuls;
- pas hapjes së plotë dhe para një kërcimi të mundur prapa, kapaku është i ngritur në pozicionin e tij fillestar.

Prova nr.3: Rrokullisja e kontejnerit mbi një rrugë artificiale të parregullt

Për këtë provë, përdoret një pistë artificiale prove dhe simulohet një terren i parregullt. Kjo pistë prove përbëhet nga dy shirita paralele të një rrjete çeliku (6 metra e gjatë dhe 400 mm e gjerë), fiksohen në planin e rrafshët dhe të shndritshëm rreth çdo 20 cm. Distanca midis dy shiritave është përshtatur në përputhje me llojin e kontejnerit, në mënyrë që të lejojë rrotat të rrokullisen në të gjithë gjatësinë e pistës.

Kushtet e instalimit duhet të sigurojnë një sipërfaqe të sheshtë. Nëse është e nevojshme, pista fiksohet në terren me materiale elastike për të shmangur emetimin e zhurmave parazitë. Shënim. Çdo brez mund të përbëhet nga disa elemente 400 mm të gjera të montuara/përshtatura së bashku.

Një shembull i një piste të përshtatshme është dhënë në figurat 39.1 dhe 39.2. Operatori është vendosur në anë të kapakut i varur me mentesha.

Matja kryhet, kur operatori tërheq kontejnerin përgjatë pistës artificiale, me një shpejtësi konstante prej rreth 1 m/s, midis pikave A dhe B (4,24 m përmasë, shih figurën 39.3), kur boshti i rrotës së parë arrin në pikën A ose B, si në rastin e një kontejneri me 2 rrota, ashtu edhe kur

kontejneri është me 4 rrota. Kjo procedurë përsëritet tre herë në çdo drejtim.

Gjatë provës për një kontejner me 2 rrota, këndi ndërmjet kontejnerit dhe pistës duhet të jetë 45°. Për një kontejner me 4 rrota, operatori duhet të sigurojë një kontakt të përshtatshëm të të gjitha rrotave me pistën.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit që rezulton në qoftë se është përdorur më shumë se një kusht pune, prova nr.1 dhe nr.2.

Mbyllja e lirë e kapakut përgjatë trupit të kontejnerit dhe hapja e plotë e kapakut. Nëse është e mundur, matjet kryhen në të njëjtën kohë në gjashtë pozicionet e mikrofonit. Në të kundërt, nivelet e tingullit të matura në çdo pozicion mikrofoni do të klasifikohen në radhën rritëse dhe nivelet e fuqisë së tingullit llogariten duke lidhur vlerat në çdo pozicion mikrofoni sipas rreshtit të tyre.

Niveli i ponderuar A i presionit të tingullit për një rast/ngjarje të vetme, matet për secilin nga 20 mbylljet dhe 20 hapjet e kapakut në çdo pikë matjeje.

Nivelet e fuqisë së tingullit LWA të mbylljes dhe LWA të hapjes janë llogaritur nga mesatarja kuadratike e pesë vlerave më të larta të marra ndërmjet tyre.

Prova nr.3: Rrokullisja e kontejnerit në një pistë të parregullt artificiale


Periudha e vëzhgimit T duhet të jetë e barabartë me kohëzgjatjen e nevojshme për të mbuluar distancën ndërmjet pikës A dhe pikës B në piste.

Niveli i fuqisë së tingullit LWA në rrokullisje është e barabartë me mesataren e gjashtë vlerave që ndryshojnë me më pak se 2 dB. Nëse ky kriter nuk është plotësuar me gjashtë matje, cikli përsëritet aq sa është e nevojshme.

Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit llogaritet nga:


$$L_{WA} = 10 \log \frac{1}{3} (10^{0,1L_{WAshutting}} + 10^{0,1L_{WAopening}} + 10^{0,1L_{WArolling}})$$

Figura 39.1
Vizatimi i pistës rrokullisëse




1. Tako druri i rrjetës së telit
2. Pjesa rrokullisëse
3. Përshtatur për kontejnerin

Figura 39.2
Detaje të ndërtimit dhe montimit të pistës rrokullisëse



1. Fije çeliku e papërkulshme (4mm)
Rrjetë e thurur (50mm x 50 mm)
2. Tako druri i rrjetës së telit (20mmx 25 mm)
3. Plani pasqyrues

Figura 39.3
Matja e distancave
(1. Cernierë)



20.40. Shata me motor:
shiko nr.20.32.

Ky mjet duhet të jetë i stakuar gjatë matjes.

20.41. Lustruesit/shtruesit e materialeve për shtrim rruge

Standardet bazë për emetimin e zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Motori i makinës duhet të punojë me shpejtësi nominale të përcaktuar nga fabrikuesi. Të gjitha njësitë e punës duhet të aktivizohen dhe të punojnë me shpejtësinë e mëposhtme. Sistemi transportues duhet të punojë me të paktën 10% të vlerës maksimale, sistemi shpërndarës me të paktën 40% të vlerës maksimale, ai përzierës (shpejtësi, goditje) me të paktën 50% e vlerës maksimale, vibruesit (shpejtësia, momenti çekuilibrit) me të paktën 50% të vlerës maksimale, presioni në bar (frekuenca, shtypja) me të paktën 50% të vlerës maksimale.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.42. Pajisje me platforme shtyllash

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 6395:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Pajisja duhet instaluar në krye të një shtylle e cila ka rezistencë të mjaftueshme në tokë për të lejuar pajisjen të punojë me një shpejtësi të qëndrueshme. Në rastin e çekanëve përplasës, kapaku duhet të sigurohet me një tjetër prej materiali mbushës prej druri.

Pjesa e sipërme e shtyllës është 0,50 metra mbi zonën e provës.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.43. Vendosës tubash:

shiko nr.20.0.

20.44. Zinxhir pistash:

shiko nr.20.0.

20.45. Gjeneratorë energjie

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Korrigjim mjedisi K2A

Matja në mjedis të hapur $K2A = 0$.

Matje në hyrje

Vlera e konstantes K2A , e përcaktuar pa sipërfaqen artificiale dhe në përputhje me aneksin A të SSH EN ISO 3744:2007 duhet të jetë $\leq 2,0$ dB, ku K2A nuk merret parasysh

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave. Hemisferë/6 pozicione të mikrofonit sipas pikës 18.5/në përputhje me pikën 19.5. Në qoftë se $l > 2m$, mund të përdoret një paralelepiped sipas SSH EN ISO 3744:2007 me distancën $d = 1$ m.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjes

Gjeneratorët e energjisë duhet të instalohen në plan të rrafshet të shndritshëm; trung-gjeneratorët e energjisë së montuar duhen vendosur në një mbështetëse 0,40 m të lartë, përveç nëse kërkohet ndryshe në kushtet e instalimit të fabrikuesit.

Prova me ngarkesë

SSH ISO 8528-10:2008 pika 9.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.46. Fshirës me energji

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Fshirëset me energji do të provohen në pozicion të palëvizshëm. Motori dhe njësitë ndihmëse do të punojnë me shpejtësinë e dhënë nga fabrikuesi për funksionimin e pajisjes së punës; fshesa punon në shpejtësinë maksimale të saj, ajo nuk është në kontakt me tokën, sistemi i thithës do të punojë me fuqinë thithëse maksimale me largësi ndërmjet tokës dhe grykës të sistemit thithës që nuk kalon 25 mm.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda

20.47. Automjete për mbledhjen e mbeturinave urbane

Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës
Prova me ngarkesë

Automjetet për grumbullimin e mbeturinave duhet të provohen në një pozicion të palëvizshëm për kushtet e mëposhtme të punës:

a) Motori funksionon me shpejtësinë maksimale të dhënë nga fabrikuesi. Pajisja nuk duhet të funksionojnë. Kjo provë nuk kryhet vetëm për automjetet me energji elektrike;

b) Sistemi i ngjeshjes është në funksionim.

Automjeti i mbledhjes së mbeturinave dhe hinka e pranimit të mbeturinave është bosh. Nëse shpejtësia e motorit përshpejtohet automatikisht kur sistemi i ngjeshjes është duke funksionuar, kjo vlerë duhet të matet. Në qoftë se vlera e matur është më e ulët sesa shpejtësia e dhënë nga fabrikuesi me më shumë se 5%, prova duhet të kryhet me motor të përshpejtuar nga përshpejtuesi i kabinës, për të përfutur shpejtësinë e motorit të dhënë nga fabrikuesi. Nëse shpejtësia e motorit për sistemin e ngjeshjes nuk është dhënë nga fabrikuesi, apo në qoftë se automjeti nuk është pajisur me një përshpejtues automatik, atëherë shpejtësia e motorit e lëshuar nga përshpejtuesi/akseleratori i kabinës duhet të jetë 1 200 rr/min;

c) Pajisja ngritëse funksionon lart dhe poshtë, pa ngarkesë dhe pa kontejner. Shpejtësia e motorit merret dhe kontrollohet si për funksionimin e sistemit të ngjeshjes (pika b);

d) Materiali bien në automjetin e mbledhjes së mbeturinave.

Materialët janë zbrazur në sasi të mëdha me pajisjen ngritëse në bunker (fillimisht bosh). Një kontejner me dy rrota me një kapacitet 240 l, në përputhje me SSH EN 840-1:2007 do të përdoret për këtë punë. Nëse pajisja ngritëse nuk është në gjendje të ngrejë një kontejner të tillë, do të përdoret një kontejner me një kapacitet afërsisht 240 l. Materiali do të qëndrojë në 30 tuba PVC-je, secili me një masë të përafërt 0,4 kg dhe me përmasat e mëposhtme:

- Gjatësia: 150 mm $\pm$ 0,5 mm;
- Diametri nominal i jashtëm: 90 mm + 0,3/- 0 mm;
- Thellësia nominale: 6,7 mm + 0,9/- 0 mm.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë të zërit që rezulton në qoftë se përdoret më shumë se një kusht pune.

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë:

a) të paktën 15 sekonda. Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit duhet të jetë LWA1;

b) të paktën tri cikle të plota, në qoftë se sistemi i ngjeshjes funksionon automatikisht.

Nëse sistemi nuk funksionon automatikisht, por cikël pas cikli, atëherë matjet duhet të kryhen të paktën gjatë tri cikleve. Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit (LWA2) do të jetë rrënja katrore e vlerës së tri (apo më shumë) matjesh;

c) të paktën tri cikle të vazhdueshme të plota të punës, duke përfshirë tërësinë e pajisjes ngritëse lart dhe pajisjes ngritëse poshtë. Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit (LWA3) do të jetë rrënja katrore e vlerës mesatare e tri (apo më shumë) matjeve;

d) të paktën tri cikle të përfunduara pune, secili duke përfshirë edhe rënien e 30 tubave në bunker. Çdo cikël nuk duhet t'i kalojë 5 sekonda. Për këto matje LpAeq, T zëvendësohet me LPA, 1s. Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit (LWA4) do të jetë rrënja katrore e vlerës mesatare të tri (ose më shumë) matjesh;

Rezultati i nivelit të fuqisë së tingullit llogaritet nga:

$$L_{WA} = 10 \log (0,06 \times 10^{0,1L_{WA1}} + 0,53 \times 10^{0,1L_{WA2}} + 0,4 \times 10^{0,1L_{WA3}} + 0,01 \times 10^{0,1L_{WA4}})$$

Shënim. Në rast të një automjeti mbledhjes mbeturinash vetëm me furnizim elektrik, koeficienti shoqërues për LWA1 supozohet të jetë e barabartë me 0.

20.48. Makina për prishjen dhe bluarjen e asfaltit të rrugëve

Standardet bazë të emetimit të zhurmës
SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës
Montimi i pajisjeve

Boshti i gjatësisë së makinës bluarëse të rrugës do të jetë paralel me boshtin Y.

Prova me ngarkesë

Makina bluarëse e rrugës, duhet të sillet në gjendjen e saj të qëndrueshme brenda kufijve të caktuar në udhëzimet e dhëna për blerësin. Motori dhe të gjitha pjesët shtojcë do të funksionojnë me shpejtësitë e tyre përkatëse nominale në regjimin pa ngarkesë.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.49. Shkrifërues

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 11094:2008.

Në rast të dyshimit, matjet do të kryhen në atmosferë të hapur mbi sipërfaqe artificiale (pika 4.1.2 e SSH ISO 11094:2008).

Korrigjim mjedisi K2A

Matja në mjedis të hapur

$K2A = 0$.

Matje në hyrje

Vlera e konstantes K2A, e përcaktuar pa sipërfaqen artificiale dhe në përputhje me aneksin A e SSH EN ISO 3744:2007 do të jetë $\leq 2,0$ dB, ku K2A nuk merret parasysh.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave:

SSH ISO 11094:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Shkrifëruesi do të punojë me motor në shpejtësinë e tij nominale dhe pajisjet e tij të punës punojnë bosh (funksionim, por jo me ngarkesë të madhe).

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të paktën të jetë 15 sekonda.

20.50. Grirëse/prerës/çarës/copëtues në sipërfaqe ose në tehe të materialit

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Zona e provës

SSH ISO 11094:2008.

Korrigjim mjedisi K2A

Matja në mjedis të hapur $K2A_r = 0$.

Matje në hyrje

Vlera e konstantes K2A, e përcaktuar pa sipërfaqen artificiale dhe në përputhje me aneksin A e SSH EN ISO 3744:2007, do të jetë $\leq 2,0$ dB, ku K2A nuk merret parasysh.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave:

SSH ISO 11094:2008.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Grirësi/copëtuesi duhet të provohet duke grirë/copëzuar një ose më shumë copë druri.

Cikli i punës konsiston në copëzimin e një cope të rrumbullakët druri (pisha e thatë ose kompensatë) me gjatësi të paktën 1,5 m, që është mprehur në një anë dhe ka një diametër afërsisht të barabartë me maksimumin që grirësja/copëzuesi të pranojë siç specifikohet në instruksionet e dhëna për blerësin.

Periudha e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit të rezultuar

Periudha e vëzhgimit do të përfundojë kur nuk ka më material në zonën e copëtimit, por kjo nuk duhet të kalojë 20 sekonda. Nëse të dyja kushtet e punës janë të mundshme, duhet të jepet niveli më i lartë i fuqisë së tingullit.

20.51. Makina e heqjes së borës me mjete rrotulluese

Standardet bazë për emetimin e zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Ventilatori i borës do të provohet në një pozicion të palëvizshëm. Ventilatori i borës duhet të punojë, sipas rekomandimeve të fabrikuesit, me pajisjet e punës me shpejtësinë e tij maksimale dhe motori me shpejtësinë korresponduese.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.52. Automjete thithëse

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Automjeti thithës duhet të provohet në një pozicion të palëvizshëm. Motori dhe njësitë ndihmëse duhet të punojnë me shpejtësinë e dhënë nga fabrikuesi për funksionimin e pajisjeve të punës; pompa(t) e vakuumit është (janë) në punë me shpejtësinë maksimale të saj (tyre), të dhënë nga fabrikuesi. Pajisja thithëse punon në mënyrë të tillë që presioni i brendshëm të jetë i barabartë me presionin atmosferik (vakum 0%). Rrjedha e zhurmës në grykën e thithjes nuk duhet të ketë ndonjë ndikim mbi rezultatet e matjeve

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.53. Vinça kullë

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

Matjet një terren të niveluara

Hemisferë/6 pozicione të mikrofonit sipas pikës 19.5/sipas pikës 19.5.

Matje të kryera në majë të krahut të vinçit

Kur mekanizmi i ngritjes është i vendosur në majën e krahut të vinçit, sipërfaqja e matjes do të jetë një sferë me rreze 4 m, qendra e së cilës do të përkojë me qendrën gjeometrike të makarasë (çikrikut).

Kur matja bëhet me mekanizmin e ngritjes me qëndrim në krahun e vicit, zona e sipërfaqes së matjes është një sferë, S është e barabartë me 200 m^2 .

Pozicionet e mikrofonit duhet të jenë si më poshtë (shih figurën 53.1):

Katër pozicionet e mikrofonit në një plan horizontal kalojnë nëpër qendrën gjeometrike të mekanizmit ($H = h/2$) me $L = 2,80 \text{ m}$ dhe $d = 2,80 - l/2$.

L = gjysmë përmasa mes dy pozicioneve të mikrofonit rresht;

l = gjatësia e mekanizmit (përgjatë boshtit të krahut të vinçit);

gjerësi b = e mekanizmit;

lartësi h = e mekanizmit;

d = përmasa mes mbështetëses së mikrofonit dhe mekanizmit në drejtim të krahut të vinçit.

Dy pozicionet e tjera të mikrofonit duhet të jenë të vendosura në pikat e ndërprerjes së sferës dhe të vijës vertikale që kalon përmes qendrës gjeometrike e mekanizmit.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Matja e mekanizmit të ngritjes

Gjatë provës mekanizmi i ngritjes do të jetë i montuar në një nga mënyrat e mëposhtme.

Pozicioni duhet të përshkruhet në raportin e provës:

a) Mekanizmi i ngritjes në nivelin e tokës. Vinçi i montuar duhet të vendoset në një sipërfaqe të sheshtë të shndritshme të betonit ose të asfaltit joporoz;

b) Mekanizmi i ngritjes me qëndrim në krahun e vinçit. Mekanizmi i ngritjes do të jetë së paku 12 metra mbi tokë;

c) Mekanizmi i ngritjes fiksuar në tokë. Mekanizmi i ngritjes do të jetë i fiksuar në një sipërfaqe të sheshtë të shndritshme të betonit ose të asfaltit joporoz.

Matja e gjeneratorit elektrik

Kur gjeneratori elektrik është i lidhur me vinçin, nëse është lidhur ose jo me mekanizmin e ngritjes, vinçi do të montohet mbi një sipërfaqe të sheshtë të shndritshme të betonit ose asfaltit joporoz.

Kur mekanizmi i ngritjes është i vendosur me qëndrim në krahun e vinçit, matja e zhurmës mund të kryhet me mekanizmin ose të montuar në krahun e vinçit ose të fiksuar në tokë. Kur burimi i energjisë elektrike të vinçit është i pavarur nga ai (gjeneratori ose linjat kryesore elektrike apo burimi energjisë hidraulike ose pneumatike), do të matet vetëm niveli i zhurmës të mekanizmit të çikrikut (makarasë).

Kur gjeneratori i energjisë është i lidhur me vinçin, gjeneratori i energjisë dhe mekanizmi i ngritjes do të maten veç e veç, në qoftë se ata nuk janë të bashkuar. Kur këto dy pajisje janë të bashkuara, matja do të referohet në të gjithë montimin (ansamblin).

Gjatë provës mekanizmi i ngritjes dhe gjeneratori i energjisë duhet të instalohen dhe përdoren në përputhje me udhëzimet e fabrikuesit.

Prova pa ngarkesë

Gjeneratori i energjisë i inkorporuar në vinç do të punojë me fuqinë e plotë të përcaktuar nga fabrikuesi. Mekanizmi i ngritjes do të punojë pa ngarkesë, me çikrikun e tij kthyer në shpejtësinë rrotulluese korresponduese me shpejtësinë maksimale të zhvendosjes fikse, në mjetet e ngritjes dhe uljes. Kjo shpejtësi duhet të specifikohet nga fabrikuesi. Për rezultatet e provës merret niveli më i lartë i të dyja niveleve të fuqisë së tingullit (ngritja ose ulja).

Prova me ngarkesë

Gjeneratori i energjisë inkorporuar në vinç do të punojë me vlerën e plotë të fuqisë së përcaktuar nga fabrikuesi. Mekanizmi i ngritjes do të punojë me një kablo tensioni në çikrikun (tamburin) përkatës me ngarkesë maksimale (për rreze minimale) me lëvizje fikse në shpejtësinë maksimale. Ngarkesa dhe shifrat e shpejtësisë duhet të jenë të specifikuara nga fabrikuesi. Shpejtësia duhet të kontrollohet gjatë provës.

Periudha(t) e vëzhgimit/përcaktimi i nivelit të fuqisë së tingullit rezulton se është përdorur më shumë se një kusht pune.

Për matjen e nivelit të presionit të tingullit të mekanizmit të ngritjes, periudha e matjes do të jetë $(t_r + t_f)$ sekonda: t_r është periudha në sekonda para aktivizimit të frenave, me mekanizmin e ngritjes që punon në mënyrë të specifikuar si më sipër. Për qëllime të provës $t_r = 3$ sekonda.

t_f është periudha në sekonda midis momentit kur freni është i aktivizuar dhe kur fiksuesi vjen për një qëndrim të plotë. Nëse është përdorur njësuës, periudha e integritit do të jetë e barabartë me $(t_r + t_f)$ sekonda.

Vlera mesatare e rrënjës katrore në një pozicioni të mikrofonit jepet nga:

$$L_{pi} = 10 \lg [(t_r 10^{0,1L_{ri}} + t_f 10^{0,1L_{fi}}) / (t_r + t_f)].$$

L_{ri} është niveli i presionit të tingullit në pozicionin e mikrofonit i gjatë periudhës t_r .


L_{fi} është niveli i presionit të zërit në pozicionin e mikrofonit gjatë periudhës së pushimit (ndërprerjes) t_f .

Figura 53.1.

Rregullimi i pozicioneve të mikrofonit kur mekanizmi i ngritjes ndodhet me qëndrim në pjesën e sipërme të krahut të vinçit.

Figura 53.1

Rregullim i pozicioneve të mikrofonit kur mekanizmi i ngritjes qëndron në pjesën e sipërme të krahut të vinçit



20.54. Gërmues:

shiko nr.20.0.

20.55. Kamionpërzierës

Standardet bazë për emetimin e zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Kushtet e punës gjatë provës

Prova me ngarkesë

Kamioni përzierës duhet të provohet në gjendje të palëvizshme. Tamburi është mbushur me beton me dendësi (trashësi) të mesme (masa e përhapjes 42-47 cm), në përputhje me kapacitetin e vlerësuar. Motori i transmensionit të tamburit do të punojë me shpejtësinë që shkakton shpejtësinë maksimale të tamburit, të përcaktuar në udhëzimet e dhëna për blerësin.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.56. Njësitë e pompave të ujit

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matja e përmasave

Paralelepiped/sipas SSH EN ISO 3744:2007 me distancën e matjes $d = 1$ m

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Njësia e pompës së ujit duhet të jetë e instaluar në planin e rrafshët dhe të shndritshëm. Njësitë e pompës së ujit montuar në trung do të vendosen në një mbështetëse 0,40 m të lartë, përveçse nëse kërkohet ndryshe nga fabrikuesi në kushtet e instalimit.

Prova me ngarkesë

Motori duhet të punojë në pikën e efikasitetit më të mirë të dhënë në udhëzimet e fabrikuesit.

Periudha e vëzhgimit

Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

20.57. Gjeneratorë saldimi

Standardet bazë të emetimit të zhurmës

SSH EN ISO 3744:2007.

Korrigjim mjedisi K2A

Matja në pamje të hapur

$K2A = 0$.

Matja në hyrje

Vlera e K2A konstante, e përcaktuar në përputhje me aneksin A të SH EN ISO 3744:2007, do të jetë $\leq 2,0$ dB, në të cilin rast K2A do të merret parasysh.

Sipërfaqja e matjes/numri i pozicioneve të mikrofonit/matje e përmasave

Hemisferë/6 pozicione të mikrofonit sipas pikës 18/5/sipas 18/5.

Në qoftë se $l > m^2$: një paralelepiped sipas SSH EN ISO 3744:2007 mund të përdoret në matjen e përmasave $d = 1m$.

Kushtet e punës gjatë provës

Montimi i pajisjeve

Gjeneratorët e saldimit duhet të instalohen në plane të rrafshëta të shndritshme, gjeneratorët e saldimit montuar në trung duhet të vendosen në një mbështetëse 0,40 m të lartë, përveçse nëse kërkohet ndryshe nga fabrikuesi në kushtet e instalimit.

Prova me ngarkesë


SSH ISO 8528-10:2008 pika 9.

Periudha e vëzhgimit


Periudha e vëzhgimit duhet të jetë të paktën 15 sekonda.

21. MODELET E MARKIMIT CE TË KONFORMITETIT DHE TË TREGUESIT TË NIVELIT TË GARANTUAR TË FUQISË SË TINGULLIT

Markimi i konformitetit CE përbëhet nga inicialet “CE” sipas formës së mëposhtme:



Nëse markimi CE zvogëlohet ose zmadhohet sipas madhësisë së pajisjes, duhet të respektohen proporcionet e dhëna në skicën e mësipërme. Komponentët e ndryshëm të markimit CE duhet të kenë kryesisht të njëjtën përmasë vertikale, e cila nuk mund të jetë më pak se 5 mm. Treguesi i nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit duhet të përbëhet nga një numër i vetëm i fuqisë së garantuar të tingullit në dB, shenja L_{WA} dhe një piktogram ka formën e mëposhtme:



Në qoftë se treguesi është zvogëluar ose zmadhuar sipas madhësisë së pajisjes, duhet të respektohen proporcionet e dhëna në vizatimin e mësipërme. Megjithatë, përmasa vertikale e treguesit nuk duhet të jetë më pak se 40 mm, nëse është e mundur.

22. KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT

22.1. Kjo pikë përshkruan procedurën ku fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i cili kryen detyrimet e përcaktuara në pikën 22.2, siguron dhe deklaron se pajisja në fjalë plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, duhet të vendosin markimin CE të konformitetit dhe treguesin e nivelit të garantuar të fuqisë së tingullit, siç kërkohe në pikën 11, në çdo pjesë të pajisjeve dhe harton me shkrim një deklaratë EC të konformitetit, siç kërkohe në pikën 8.

22.2. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, duhet të përgatisë dokumentacionin teknik të përshkruar në pikën 22.3 dhe duhet ta mbajë atë në dispozicion të autoriteteve përkatëse kombëtare për qëllime inspektimi për një periudhë që mbaron të paktën pas 10 vjetësh pasi produkti i fundit është prodhuar. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, mund t'ia besojnë një personi tjetër mbajtjen e dokumentacionit teknik. Në këtë rast ai përfshin emrin dhe adresën e këtij personi në deklaratën EC të konformitetit.

22.3. Dokumentacioni teknik duhet të bëjë të mundur vlerësimin e konformitetit të pajisjeve me kërkesat e këtij rregulli teknik dhe duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën e fabrikuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- një përshkrim të përgjithshëm të pajisjes;
- modelin/paraqitjen/formën/stilin;
- emrin tregtar;
- llojin, seritë dhe numrat;
- të dhënat teknike përkatëse për identifikimin e pajisjes dhe vlerësimin e emetimit të saj të zhurmës, përfshirë sipas rastit edhe vizatimet skematike dhe ndonjë/çdo përshkrim dhe shpjegim të nevojshëm për të kuptuarit e tyre;
- referencën në këtë rregull teknik;
- raportin teknik të matjeve të zhurmës së kryer në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik;
- instrumentet teknike të përdorur dhe rezultatet e vlerësimit të pasigurive për shkak të ndryshimit të prodhimit dhe lidhja e tyre me nivelin e garantuar të fuqisë së tingullit.

22.4. Fabrikuesi duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë vazhdimësinë e konformitetit të pajisjeve të prodhuara me dokumentacionin teknik të përmendur në pikat 22.2 dhe 22.3, si dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

23. KONTROLLI I BRENDSHËM I PRODHIMIT ME VLERËSIMIN E DOKUMENTACIONIT TEKNIK DHE KONTROLLIT PERIODIK

23.1. Kjo pikë përshkruan procedurën me të cilën fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i cili kryen detyrimet e përcaktuara në pikat 23.2, 23.5 dhe 23.6 siguron dhe deklaron se pajisja në fjalë plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, duhet të vendosë markimin CE të konformitetit dhe treguesin e nivelit të garantuar të

fuqisë së tingullit, siç kërkohet në pikën 10, në çdo pjesë pajisjeje dhe harton me shkrim një deklaratë EC të konformitetit, siç kërkohet në pikën 8.

23.2. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të hartojë dokumentacionin teknik të përshkruar në pikën 23.3 dhe e mban atë për një periudhë të paktën 10 vjet pas prodhimit të produktit të fundit, në dispozicion të autoriteteve përkatëse kombëtare për qëllime inspektimi. Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, mund t'ia besojë një personi tjetër mbajtjen e dokumentacionit teknik. Në këtë rast ai duhet të përfshijë emrin dhe adresën e këtij personi në deklaratën EC të konformitetit.

23.3. Dokumentacioni teknik duhet të mundësojë vlerësimin e konformitetit të pajisjes me kërkesat e këtij rregulli teknik. Ai duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën e fabrikuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- një përshkrim të pajisjes;
- modelin/paraqitjen/formën/stilin;
- emrin, tregtar;
- llojin, seritë dhe numrat;
- të dhënat teknike përkatëse për identifikimin e pajisjes dhe vlerësimin e emetimit të saj të zhurmës, përfshirë sipas rastit edhe vizatimet skematike dhe ndonjë/çdo përshkrim dhe shpjegim të nevojshëm për të kuptuarit e tyre, nëse është e përshtatshme;
- referencën në këtë rregull teknik;
- raportin teknik të matjeve të zhurmës të kryera në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik;
- instrumentet teknike të përdorura dhe rezultatet e vlerësimit të pasigurive për shkak të ndryshimit të prodhimit dhe lidhja e tyre me nivelin e garantuar të fuqisë së tingullit.

23.4. Fabrikuesi duhet të marre të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që procesi i prodhimit të sigurojë përputhshmërinë e pajisjeve të prodhuara me dokumentacionin teknik të përmendur në pikat 23.2 dhe 23.3, dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik.

23.5. Vlerësimi nga organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar para vendosjes në treg

Fabrikuesi, ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, paraqet një kopje të dokumentacionit të tij teknik te një organ i autorizuar/organizmi europian i notifikuar sipas zgjedhjes së tij para se artikulli i parë i pajisjes të jetë vendosur në treg dhe/ose vënë në shërbim.

Nëse ka dyshime për besueshmërinë e dokumentacionit teknik, organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar informon në përputhje me rrethanat, fabrikuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar, dhe nëse është e nevojshme, kryen ose ka kryer modifikimet në dokumentacionin teknik, apo mundësisht testet e konsideruara të nevojshme. Pasi organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar ka lëshuar një raport që konfirmon se dokumentacioni teknik plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik, fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE në pajisje dhe lëshon një deklaratë EC të konformitetit, në përputhje me pikat 10 dhe 8, për të cilat ai mban përgjegjësi të plotë.

23.6. Vlerësimi nga organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar gjatë prodhimit

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, do të përfshijë më tej organin e autorizuar/organizmin europian të notifikuar në fazën e prodhimit sipas njëres prej procedurave të mëposhtme që zgjidhet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar:

- organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar kryen kontrole periodike në mënyrë që të verifikojë vazhdueshmërinë e përputhshmërisë së pajisjes së prodhuar me dokumentacionin teknik dhe me kërkesat e këtij rregulli teknik. Në veçanti organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar përqendrohet në:
- markimin e saktë dhe të plotë të pajisjes sipas pikës 10;
- lëshimin e deklaratës EC të konformitetit sipas pikës 8;
- instrumentet teknike të përdorura dhe rezultatet e vlerësimeve të pasigurive për shkak të ndryshimit të prodhimit dhe lidhjen e tyre me nivelin e garantuar të fuqisë së tingullit.

Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, i jep organit të autorizuar/organizmit evropian të notifikuar akses të lirë në të gjithë dokumentacionin e brendshëm që mbështet këto procedura, rezultatet aktuale të auditimeve të brendshme dhe veprimet korrigjuese që janë ndërmarrë, nëse ka ndonjë. Vetëm nëse kontrollet e mësipërme japin rezultate të pakënaqshme, organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar kryen vetë provat e zhurmës, të cilat sipas gjykimit dhe përvojës së vet, mund të thjeshtohen ose të kryhen plotësisht sipas dispozitave të parashikuara në pikën 18 për llojin përkatës të pajisjes;

- organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar, do të kryejë ose ka kryer kontrolle të produktit në intervale të rastësishme. Një mostër/tip i përshtatshëm i pajisjes përfundimtare, e zgjedhur nga organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar, duhet të shqyrtohet dhe të kryhen provat e duhura të zhurmave siç përcaktohet në pikën 18, ose prova ekuivalente, për të kontrolluar përputhshmërinë e produktit me kërkesat përkatëse të këtij rregullit teknik. Kontrolli i produktit përfshin aspektet e mëposhtme:

- markimin e saktë dhe të plotë të pajisjes sipas pikës 10;
- lëshimin e deklaratës EC të konformitetit sipas pikës 8.

Në të dyja procedurat, frekuenca/shpeshtësia e kontrolleve përcaktohet nga organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar në bazë të rezultateve të vlerësimeve të mëparshme, të nevojës për të monitoruar veprimet korrigjuese dhe në bazë të udhëzimeve të mëtejshme për frekuencën e kontrolleve që mund të jepen nga prodhimi vjetor dhe besueshmëria e përgjithshme e fabrikuesit për të ruajtur vlerat e garantuara. Megjithatë, një herë në tre vjet duhet të kryhet të paktën një kontroll.

Nëse ka dyshime rreth besueshmërisë së dokumentacionit teknik ose zbatimin gjatë prodhimit, organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar duhet të informojë në përputhje me rrethanat fabrikuesin ose përfaqësuesin e tij të autorizuar.

Në ato raste kur pajisja e kontrolluar nuk përputhet me dispozitat e këtij rregulli teknik, organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar informon ministrin përgjegjës për autorizimin e organit të autorizuar/organizmit evropian të notifikuar

24. VERIFIKIMI I NJËSISË

24.1. Kjo pikë përshkruan procedurën ku fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, siguron dhe deklaron se pajisja e cila është lëshuar me certifikatën e përmendur në pikën 24.4 përputhet me kërkesat e këtij rregulli teknik. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar duhet të vendosë në pajisje markimin CE të plotësuar nga informacioni, siç kërkohet në pikën 10 dhe harton deklaratën EC të konformitetit referuar në pikën 8.

24.2. Kërkesa për një verifikim njësie paraqitet nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar në një organ të autorizuar/organizëm evropian të notifikuar të zgjedhur prej tij. Kjo kërkesë duhet të përmbajë:

- emrin dhe adresën e fabrikuesit dhe, nëse kërkesa është paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar, edhe emrin dhe adresën e tij;
- një deklaratë me shkrim se një kërkesë e njëjtë nuk është paraqitur pranë ndonjë organi tjetër të autorizuar/organizmi evropian të notifikuar;
- Dokumentacionin teknik në përputhje me kërkesat e përcaktuara më poshtë:
- një përshkrim të pajisjes;
- emrin tregtar;
- llojin, seritë dhe numrat;
- të dhënat teknike që kanë lidhje me identifikimin e pajisjes dhe vlerësimin e emetimit të saj të zhurmës, përfshirë sipas rastit edhe vizatimet skematike dhe çdo/ndonjë përshkrim dhe shpjegim të nevojshëm për të kuptuarit e tyre, nëse është e përshtatshme;
- referencën në këtë rregull teknik.

24.3. Organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar duhet:

- të shqyrtojë nëse pajisja është prodhuar në përputhje me dokumentacionin teknik;
- të bjerë dakord me kërkuuesin për vendin se ku do të kryhen provat e zhurmave në përputhje me këtë rregull teknik;

- të kryejë ose ketë kryer provat e nevojshme të zhurmës/ave në përputhje me këtë rregull teknik.

24.4. Kur pajisja plotëson dispozitat e këtij rregulli teknik, organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar duhet t'i lëshojë aplikantit një certifikatë konformiteti siç përshkruhet në pikën 27.

Nëse organi i autorizuar/organizmi europian i notifikuar refuzon të lëshojë një certifikatë konformiteti, ai duhet të përcaktojë arsyet e hollësishme për këtë refuzim.

24.5. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar, duhet të mbajë me dokumentacionin teknik kopje të certifikatës së konformitetit për një periudhë 10-vjeçare që nga data kur është vendosur pajisja në treg.

25. SIGURIMI I PLOTË I CILËSISË

25.1. Kjo pikë përshkruan procedurën ku fabrikuesi që plotëson detyrimet e pikës 25.2 siguron dhe deklaron se pajisja në fjalë plotëson kërkesat e këtij rregulli teknik. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar vendos markimin CE të plotësuar me informacion, siç kërkohet në pikën 10 në çdo produkt dhe harton me shkrim deklaratën EC të konformitetit të referuar në pikën 8.

25.2. Fabrikuesi duhet të operojë në një sistem të miratuar të sigurimit të cilësisë për projektimin, prodhimin dhe inspektimin final të produktit dhe provës siç përcaktohet në pikën 25.3 dhe duhet t'i nënshtrohet mbikëqyrjes, siç specifikohet në pikën 25.4.

25.3. Sistemi i sigurimit të cilësisë

25.3.1. Fabrikuesi dorëzon një kërkesë për vlerësimin e sistemit të tij të sigurimit të cilësisë në një organ të autorizuar/organizëm europian të notifikuar të zgjedhur prej tij.

Kërkesa duhet të përmbajë:

- të gjithë informacionin përkatës për kategorinë e produktit, duke përfshirë edhe dokumentacionin teknik të të gjitha pajisjeve që janë aktualisht në fazën e projektimit apo të prodhimit, i cili duhet të përmbajë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- emrin dhe adresën e fabrikuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar;
- një përshkrim të pajisjes;
- modelin;
- emrin tregtar;
- llojin, seritë dhe numrat;
- të dhënat teknike përkatëse për identifikimin e pajisjes dhe vlerësimin e emetimit të saj të zhurmës, përfshirë sipas rastit, edhe vizatimet skematike dhe ndonjë/çdo përshkrim dhe shpjegim të nevojshëm për të kuptuarit e tyre, nëse është e përshtatshme;
- referencën në këtë rregull teknik;
- raportin teknik të matjeve të zhurmës të kryera në përputhje me dispozitat e këtij rregulli teknik;

- instrumentet teknike të përdorur dhe rezultatet e vlerësimit të pasigurive për shkak të ndryshimit të prodhimit dhe lidhja e tyre me nivelin e garantuar të fuqisë së tingullit;

- një kopje të deklaratës EC të konformitetit;
- dokumentacionin lidhur me sistemin e sigurimit të cilësisë.

25.3.2. Sistemi i sigurimit të cilësisë duhet të sigurojë përputhjen e produktit me kërkesat e rregullit teknik që zbatohen për të.

Të gjitha elementet, kërkesat dhe dispozitat e përdorura nga fabrikuesi duhet të dokumentohen në mënyrë sistematike dhe të rregullt në formë të politikave, procedurave dhe udhëzimeve të shkruara. Dokumentacioni i sistemit të sigurimit të cilësisë duhet të lejojë një kuptim të përbashkët të politikave të cilësisë dhe të procedurave, siç janë programet e cilësisë, planet, manualët dhe regjistrat/të dhënat.

25.3.3. Dokumentacioni i sistemit të sigurimit të cilësisë duhet të përmbajë veçanërisht një përshkrim adekuat të:

- objektivave të cilësisë dhe strukturës organizative, përgjegjësi dhe kompetencat e menaxhimit në lidhje me projektin dhe cilësinë e produktit;

- dokumentacionit teknik që hartohet për çdo produkt, i cili përmban të paktën informacionin e treguar në pikën 25.3.1 për dokumentacionin teknik e përmendur atje;

- teknikave të kontrollit të projektimit dhe të verifikimit të projektimit, proceset dhe veprimet sistematike që do të përdoren gjatë projektimit të produkteve që i përkasin kategorisë së pajisjeve të mbuluara;

- teknikave përkatëse të prodhimit, të kontrollit të cilësisë dhe të sigurimit të cilësisë, proceset dhe veprimet sistematike që do të përdoren;

- ekzaminimeve dhe provave që do të kryhen para, gjatë dhe pas prodhimit, dhe frekuenca me të cilën ato do të kryhen;

- të dhënat/regjistrave të cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e testimit, të dhënat e kalibrit, raportet e kualifikimit të personelit në fjalë etj.;

- mjeteve për të monitoruar arritjen e projektimit dhe cilësisë së produktit të kërkuar dhe funksionimin efektiv të sistemit të sigurimit të cilësisë.

Organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar duhet të vlerësojë sistemin e sigurimit të cilësisë për të përcaktuar nëse ai përmbush kërkesat e referuara në pikën 25.3.2. Ai duhet të konsiderojë përputhjen me këto kërkesa në lidhje me sistemet e sigurimit të cilësisë që zbatojnë SSH EN ISO 9001.

Ekipi i auditimit duhet të ketë të paktën një anëtar me eksperiencë si vlerësues në teknologjinë e pajisjeve në fjalë. Procedura e vlerësimit duhet të përmbajë një vizitë vlerësimi në vendndodhjen e fabrikuesit.

Vendimi i njoftohet fabrikuesit. Njoftimi përmban përfundimin e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit të arsyetuar.

25.3.4. Fabrikuesi duhet të marre përsipër përmbushjen e detyrimeve që dalin nga sistemi i sigurimit të cilësisë siç është miratuar dhe mbajtjen e saj në mënyrë të duhur dhe efikase. Fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar mban të informuar organin e autorizuar/organizmin evropian i notifikuar, që ka miratuar sistemin e sigurimit të cilësisë për çdo përditësim qëllimor të sistemit të sigurimit të cilësisë. Organi autorizuar/organizmi evropian i notifikuar duhet të vlerësojë ndryshimet e propozuara dhe vendos nëse sistemi i ndryshuar i sigurimit të cilësisë do të vazhdojë të përmbushë përsëri kërkesat e referuara në pikën 25.3.2, apo nëse është i nevojshëm një rivlerësim.

Ai ia njofton vendimin e tij fabrikuesit. Njoftimi përmban konkluzionet e ekzaminimit dhe vendimin e vlerësimit të gjykuar.

25.4. Mbikëqyrja nën përgjegjësinë e organit të autorizuar/organizmit evropian të notifikuar

25.4.1. Qëllimi i mbikëqyrjes është për t'u siguruar se fabrikuesi plotëson siç duhet detyrimet që rrjedhin nga sistemi i cilësisë.

25.4.2. Fabrikuesi duhet të lejojë hyrjen e organit të autorizuar/organizmit evropian të notifikuar për qëllime inspektimi në vendet e projektimit, prodhimit, inspektimit, testimit, dhe magazinimit, dhe siguron të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:

- dokumentacionin e sistemit të sigurimit të cilësisë;

- regjistrat e cilësisë, siç parashikohet nga pjesa e projektimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, si rezultatet e analizave, llogaritjeve, provave etj.;

- regjistrat e cilësisë, siç parashikohet nga pjesa e prodhimit të sistemit të sigurimit të cilësisë, si raportet e inspektimit dhe të dhënat e provave, të dhënat e kalibrit, raportet e kualifikimit të personelit përkatës etj.;

25.4.3. Organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar kryen periodikisht kontrolle auditimi për të siguruar se fabrikuesi mban dhe zbaton sistemin e sigurimit të cilësisë dhe duhet të paraqesë një raport auditimi te fabrikuesi.

25.4.4. Përveç kësaj, organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar mund të bëjë vizita të palajmëruara të prodhuesi.

Gjatë vizitave të tilla, nëse është e nevojshme, organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar mund të kryejë ose të kërkojë të kryhen, prova për të verifikuar se sistemi i sigurimit të cilësisë funksionon si duhet. Organi i autorizuar/organizmi evropian i notifikuar i jep fabrikuesit një raport të vizitës dhe një raport prove, në qoftë se është kryer një provë e tillë.

25.5. Fabrikuesi duhet të mbajë në dispozicion të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, për një periudhë të paktën 10 vjet pas prodhimit të pajisjes së fundit:

- dokumentacionin e përmendur në pikën e dytë të pikës 25.3.1;
- përditësimin e referuar në paragrafin e dytë të pikës 25.3.4;
- vendimet dhe raportet nga organi i autorizuar, të cilat janë përmendur në paragrafin e fundit të pikës 25.3.4, pikat 25.4.3 dhe 25.4.4.

25.6. Çdo organ i autorizuar/organizëm europian i notifikuar i jep organeve të tjera të autorizuar/organizmave europiane të notifikuara informacionin e duhur në lidhje me miratimet e sistemeve të sigurimit të cilësisë të lëshuara apo dhe të tërhequra.

26. KRITERET MINIMALE QË DUHET TË PLOTËSOJNË ORGANET E AUTORIZUARA

26.1. Organi i autorizuar, drejtori dhe stafi i tij përgjegjës për kryerjen e operacioneve të verifikimit nuk mund të jenë as projektuesi, as ndërtuesi, as furnizuesi apo instaluesi i pajisjeve dhe as përfaqësuesi i autorizuar i ndonjë prej këtyre palëve. Ata nuk mund të jenë të përfshirë as direkt dhe as si përfaqësues të autorizuar në projektimin, ndërtimin, tregtimin apo mirëmbajtjen e një pajisjeje të tillë dhe as të përfaqësojnë palë të përfshira në këto aktivitete. Kjo nuk pengon mundësinë e shkëmbimit të informacionit teknik ndërmjet fabrikuesit dhe organit të autorizuar.

26.2. Organi i autorizuar dhe stafi i tij duhet të kryejnë vlerësimet dhe verifikimet me shkallën më të lartë të integritetit profesional dhe kompetencës teknike dhe duhet të jenë të lirë nga të gjitha presionet dhe nxitjet, sidomos ato financiare, të cilat mund të ndikojnë gjykimin e tyre ose rezultatet e punës së tyre, sidomos nga persona apo grupe personash me interes në rezultatet e verifikimit.

26.3. Organi i autorizuar duhet të ketë në dispozicion të tij stafin e nevojshëm dhe të ketë objektet e nevojshme për të mundësuar atë të kryejë siç duhet detyrat teknike dhe administrative të lidhura me inspektimin dhe operacionet e mbikëqyrjes. Ai duhet të ketë, gjithashtu, akses në përdorimin e pajisjeve të nevojshme për ndonjë verifikim të posaçëm.

26.4. Personeli përgjegjës për inspektimin duhet të ketë:

- trajnim të lartë profesional dhe teknik;
- njohuri të kënaqshme të kërkesave për vlerësimin e dokumentacionit teknik;
- njohuri të kënaqshme të kërkesave për provat që ata kryejnë dhe përvojën e duhur praktike për prova të tilla;
- aftësinë për të hartuar certifikatat, të dhënat dhe raportet e nevojshme për të vërtetuar performancën e provave.

26.5. Duhet të jetë e garantuar paanësia e stafit inspektues. Shpërblimi i tyre nuk duhet të varet nga numri i provave të kryera apo rezultatet e provave të tilla.

26.6. Organi i autorizuar duhet të jetë i pajisur me siguracionin e përgjegjësisë civile, përveç rastit kur përgjegjësia e tij merret përsipër nga shteti në përputhje me ligjin kombëtar, ose vetë shteti është drejtpërdrejt përgjegjës për provat.

26.7. Stafi i organit të autorizuar duhet të respektojë sekretin profesional në lidhje me të gjitha të dhënat e mbledhura në kryerjen e provave të tij (me përjashtim të autoriteteve kompetente administrative të shtetit në të cilin aktivitetet e tij kryhen), sipas këtij rregulli teknik ose ndonjë dispozite të ligjit kombëtar që jep fuqi për të.

**27. VERIFIKIMI NJËSISË
MODELI I CERTIFIKATËS SË KONFORMITETIT**

Deklarata EC e konformitetit	
Fabrikuesi	Nr. i deklaratës EC të konformitetit
Mbajtësi i deklaratës	Shpallja e rregullit teknik
Raporti i laboratorit Nr. Datë: Niveli i rezultuar i fuqisë së tingullitdB	Hyrja në fuqi e rregullit teknik / /
Përshkrimi i pajisjes Tipi i pajisjes: Emri tregtar: Nr. i tipit : Tipi i motorit/ave: Tipi i energjisë: Karakteristika të tjera të kërkesave teknike:	Kategoria: Numri i identifikimit: Fabrikuesi: Fuqia:
Dokumentet e mëposhtme që u përket numrit tregtar në kutinë 2 të aneksuar në këtë deklaratë:	
Vlefshmëria e deklaratës: (Vula) Vendi: (Firma)	

**VENDIM
Nr.672, datë 14.9.2011**

**PËR KUOTAT E PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË INSTITUCIONET
PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, PËR CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE “MASTER
PROFESIONAL”, PËR VITIN AKADEMIK 2011 - 2012**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 34, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.8098, datë 9.4.1996 “Për statusin e të verbrit”, të ligjit nr.8626, datë 4.7.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.2.1994 “Për statusin e invalidit”, të ligjit nr.7748, datë 29.7.1993 “Për statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimeve në institucionet publike të arsimit të lartë, për programet e studimeve të ciklit të dytë “Master profesional”, për vitin 2011-2012, të jenë 8898. Këto kuota të ndahen, si më poshtë vijon:

- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional” 8608;
- b) Kuotat për programe të dyta studimi 100;
- c) Kuotat për transferimin e studimeve 100;
- ç) Kuotat për të huajt 50;
- d) Kuotat për të verbrit 20;
- dh) Kuotat për romët/ballkano-egjiptianët 20.
2. Kuotat e pranimeve të reja, për programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, përbëhen nga:
- a) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët brenda territorit të vendit 8200;
- b) Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional”, për kandidatët shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit 408.
3. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit “Master profesional” sipas shkronjës “a” të pikës 1 të këtij vendimi, sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, pasqyrohen në kolonën D të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Kuotat e pranimeve të reja për programet e studimit të ciklit të dytë, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi, ndahen ndërmjet kandidatëve shqiptarë nga trojet jashtë kufijve të vendit: Republika e Kosovës, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovc dhe Medvegjë. Administrimi i këtyre kuotave kryhet në bazë të marrëveshjeve dypalëshe ndërmjet vendeve dhe akteve të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë. Këto kuota pranimi, të ndara sipas programeve të studimit dhe institucioneve publike të arsimit të lartë, për çdo program studimi, pasqyrohen në kolonën E të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Kuotat e pranimeve për personat që nuk shikojnë, ndahen për kandidatët me statusin e personave që nuk shikojnë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga Shoqata Kombëtare e të Verbërve.
6. Kuotat e pranimeve për romët dhe ballkano-egjiptianët ndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, në bazë të listës së hartuar nga shoqatat përkatëse: Shoqata Kombëtare e Romëve dhe Shoqata Kombëtare e Ballkano-Egjiptianëve.
7. Kuotat e pranimi për shtetasit e huaj, që do të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë, në ciklin e dytë të studimeve, sipas shkronjës “d” të pikës 1 të këtij vendimi, administrohen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe ndërmjet vendeve.
8. Kuotat e pranimeve për një program të dytë studimi dhe transferimi i studimeve të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, shpërndahen nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, bazuar në kërkesat e institucioneve publike të arsimit të lartë.
9. Çdo program studimi i ciklit të dytë “Master profesional”, funksionon në vitin e parë për vitin akademik 2011-2012, në rast se atë e ndjekin të paktën 10 studentë.
10. Institucionet publike të arsimit të lartë përcaktojnë kriteret e pranimi të kandidatëve dhe i bëjnë ato publike paraprakisht.
11. Tarifat e shkollimit për çdo kredit, për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, në vitin akademik 2011-2012, përcaktohen në kolonën F të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
12. Tarifat e përgjithshme të shkollimit për studentët që do të regjistrohen në vitin e parë, për të gjitha programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, në vitin akademik 2011-2012, përcaktohen në kolonën G të tabelës nr.1, bashkëlidhur këtij vendimi.
- Tarifa e përgjithshme paguhet e njëjtë, si në rastet kur kohëzgjatja normale e programit të studimit është 1,5 vite akademike, ashtu edhe në rastet kur programi i studimit zgjat më shumë, pasi ofrohet nga institucionet publike të arsimit të lartë me kohë të pjesshme. Pagesa e tarifës bëhet me kështu të përcaktuara nga institucioni i arsimit të lartë. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së paracaktuar të programit të studimit, studentët, të cilët nuk e kanë përfunduar ende programin përkatës, paguajnë vetëm tarifën për kredit të lëndëve të prapambetura.

13. Kandidatët, që do të fitojnë të drejtën në një program studimi të ciklit të dytë “Master profesional”, në institucionet publike të arsimit të lartë, në vitin akademik 2011-2012 dhe që u përkasin shtresave sociale, si: personat që nuk shikojnë dhe që nuk dëgjojnë, invalidët, invalidët e punës dhe fëmijët e tyre, paraplegjikët dhe tetraplegjikët, fëmijët që gëzojnë statusin ligjor të jetimit, fëmijët romë, ballkano-egjiptianë apo fëmijët e policëve dhe ushtarakëve të rënë për shkak të detyrës e të ish-të përndjekurve politikë, paguajnë një kuotë në masën 50% të tarifës së shkollimit. Këtë të drejtë do ta kenë edhe studentët e viteve më të larta, që u përkasin po këtyre shtresave sociale.

14. Në çdo program studimi të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional”, në vitin akademik 2011-2012, studentët e vitit të parë, që kanë përfunduar me medalje të artë ciklin e parë të studimeve dhe studentët e vitit të dytë që kanë përfunduar shkëlqyeshëm vitin e parë, nuk e paguajnë tarifën e shkollimit në vitin akademik 2011-2012.

15. Shtetasit e huaj, që do të vazhdojnë studimet e ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë, i nënshtrohen së njëjtës tarifë shkollimi, si shtetasit shqiptarë, me përjashtim të rasteve kur, me marrëveshje ndërshtetërore, është parashikuar ndryshe.

16. Transferimet e studimeve në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës, sipas shkronjës “c” të pikës 1 të këtij vendimi, bëhen nga vetë institucionet publike të arsimit të lartë, në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet nënligjore, në statutin dhe rregulloret e tyre.

17. Studentët, që përfitojnë nga kuotat e përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c” të pikës 1 të këtij vendimi, i nënshtrohen tarifës së shkollimit të programit përkatës të studimit që ata kanë kërkuar.

18. Rishpërndarja e kuotave të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të cilat mbeten të parealizuar, bëhet nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në bashkëpunim me institucionet publike të arsimit të lartë.

19. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TABELA Nr.1 KUOTAT DHE TARIFAT CIKEL II, MASTER PROFESIONAL 2011-2012

A	B	C	D	E	F	G
K_UNIVERSITETI	K_ID_Program	K_EMERTIMI_PROGRAM	Kuota per studente Shqiptare	Kuota studente nga Trojet	Tarifa per kredit, 2011-2012 (ne leke)	Tarifa totale per 90 kredite "Master Profesional", 2011-2012 (ne leke)
Universiteti i Tiranës	1	Analizë e Plotikës Sociale	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	2	Drejtim dhe Administrim Arsimit	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	3	Punë Sociale	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	4	Filozofi Praktike dhe Humane	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	5	Qeverisje dhe Politika Publike	50	3	1,500	135,000
Universiteti i Tiranës	6	Këshillim Psikologjik	40	2	1,500	135,000
Universiteti i Tiranës	7	Orientim Profesional	40	2	800	72,000
Universiteti i Tiranës	8	Redaktim	100	5	800	72,000
Universiteti i Tiranës	9	Arkivistikë	50	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	10	Histori (Mësuesi)	150	8	800	72,000
Universiteti i Tiranës	11	Gjeografi (Mësuesi)	120	6	800	72,000
Universiteti i Tiranës	12	Gjuhë-Letërsi (Mësuesi)	130	7	800	72,000
Universiteti i Tiranës	13	Fizioterapi	20	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	14	Imazhen	20	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	15	Mami	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	16	Menaxhim Infermieror	150	8	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	17	Teknikë Laboratori	40	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	18	Shëndet Publik	60	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	19	Bioteknologji mjedisore	100	5	900	81,000
Universiteti i Tiranës	20	Informatikë Biznesi	100	5	900	81,000
Universiteti i Tiranës	21	Biznes Law	70	4	800	72,000
Universiteti i Tiranës	22	E Drejtë Penale	60	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	23	E Drejtë Publike	60	3	800	72,000
Universiteti i Tiranës	24	E Drejtë Civile	60	3	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	25	Biznes Blegtoral	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	26	Cilësia dhe Siguria Ushqimore	100	5	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	27	Diagnozë Laboratorike	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	28	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Ekonomi dhe Politike Agrare"	150	8	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	29	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Financë-Kontabilitet"	150	8	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	30	Ekonomi dhe Agrobiznes, me drejtim "Menaxhimi Ndërmarrjeve të Agrobiznesit"	150	8	800	72,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	31	Klinikë Veterinare	30	2	1,000	90,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	32	Mbrojtja e Bimëve dhe Fitofarmacia	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	33	Menaxhim Mjedisi	60	3	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	34	Teknologjitë e Avancuara në Hortikulture	30	2	900	81,000
Univ. Bujqësor i Tiranës	35	Teknologjitë e Kultivimit të Bimëve	30	2	900	81,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	36	Financë-Kontabilitet	100	5	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	37	Gjuhë Angleze	40	2	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	38	Gjuhë-Letërsi AM	30	2	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	39	Gjuhë-Letërsi CLAB	70	4	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	40	Marketing	50	3	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	41	Matematikë-Fizikë	20	1	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	42	Menaxhim	70	4	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	43	Shkenca Sociale AM	60	3	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	44	Turizëm	40	2	800	72,000
Univ. "Fan S. Noli" Korçë	45	Zhvillim i Integrues Rural	40	2	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	46	Administrim Biznes	70	4	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	47	Administrim Financiar	60	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	48	Administrim Publik	60	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	49	Bankë-Financë	70	4	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	50	Didaktikë	50	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	51	Drejtim SME	40	2	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	52	Drejtim Turizmi	40	2	800	72,000

Univ. "A. Moisiu" Durrës	53	Marketing	60	3	800	72,000
Univ. "A. Moisiu" Durrës	54	Mësimdhënie Gjuhë-Letërsi	50	3	800	72,000
Univ. Politeknik i Tiranës	55	Automatizim Industri	30	2	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	56	Energjitike	25	1	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	57	Inxhinieri e Burimeve Natyrore	45	2	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	58	Inxhinieri e Materialeve	30	2	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	59	Inxhinieri Elektronike	15	1	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	60	Inxhinieri Gjeodezi	30	2	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	61	Inxhinieri Gjeofizike	0	0	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	62	Inxhinieri Gjeologjike	60	3	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	63	Inxhinieri Gjeomjedisi	15	1	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	64	Inxhinieri Hidroteknike	25	1	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	65	Inxhinieri Informatikë	15	1	1,000	90,000
Univ. Politeknik i Tiranës	66	Inxhinieri Mekanike	60	3	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	67	Inxhinieri Mjedisi	50	3	900	81,000
Univ. Politeknik i Tiranës	68	Inxhinieri Ndërtimi	90	5	1,000	90,000
Univ. Politeknik i Tiranës	69	Inxhinieri Tekstile dhe Mode	30	2	1,000	90,000
Univ. Politeknik i Tiranës	70	Inxhinieri Telekomunikacioni	15	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	71	Administrim-Biznes	50	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	72	Kontabilitet	60	3	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	73	Finance	115	6	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	74	Menaxhim Turizmi	25	1	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	75	SEE	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	76	Marketing	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	77	Administrim-Publik	30	2	1,000	90,000
Universiteti i Tiranës	78	Sisteme informacioni ne Ekonomi	40	2	1,000	90,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	79	Mësuesi Matematikë-Fizikë, me profil minor "informatikë"	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	80	Mësuesi në Biologji e Kimi	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	81	Mësuesi në Edukim Fizik e Sporte	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	82	Mësuesi në Gjuhë Shqipe e Letërsi	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	83	Mësuesi në Histori e Gjeografi	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	84	Mësuesi në Histori e Gjeografi me profil minor në Edukim qytetar	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	85	Mësuesi në Matematikë e Fizike	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	86	Mësuesi në Matematikë e Informatikë	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	87	Mësuesi në Gjuhën Angleze	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	88	Mësuesi në Gjuhën Frënge	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	89	Mësuesi në Gjuhën Gjermane	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	90	Mësuesi në Gjuhën Italiane	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	91	Mësuesi në Informatikë me profil minor në Matematikë	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	92	Mësuesi në Matematik me profil minor në informatikë	60	3	800	72,000
Univ. "L. Gurakuqi" Shkodë	93	Përkthim dhe interpretim në Gjuhën Gjermane	20	1	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	94	Administrim Publik	80	4	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	95	Infermier Kirurg	50	3	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	96	Infermier Patolog	100	5	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	97	Infermier Pediatër	50	3	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	98	Shkenca Administrative	80	4	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	99	Mësuesi në Gjuhë Angleze	50	3	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	100	Mësuesi në Gjuhë Italiane	50	3	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	101	Mësuesi në Informatikë	30	2	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	102	Mësuesi në Matematikë	30	2	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	103	Mësuesi në Matematikë-Fizike	50	3	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	104	Operacione Industriale dhe Navale	20	1	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	105	Sipërmarrje në turizëm	80	4	800	72,000
Univ. "I. Qemali" Vlorë	106	Studime të Avancuara Detare	20	1	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	107	Administrim Publik	100	5	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	108	Biologji-Kimi	50	3	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	109	Gjuhë Angleze	30	2	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	110	Gjuhë Italiane	30	2	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	111	Gjuhë Letërsi dhe Qytetërim Grek	30	2	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	112	Gjuhë-Letërsi Shqipe	70	4	800	72,000

Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	113	Histori-Gjeografi	80	4	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	114	Kontabilitet-Finance	130	7	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	115	Matematikë-Fizikë	50	3	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	116	Matematikë-Informatikë	60	3	800	72,000
Univ. "E. Çabej" Gjirokastrë	117	Turizëm	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	118	Administrim-Biznes	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	119	Drejtim dhe Administrim Arsimi	80	4	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	120	Ekonomia dhe e Drejta në Sektorin Publik	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	121	Financë	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	122	Gazetar Reporter	25	1	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	123	Gazetari Sportive	25	1	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	124	Kontabilitet	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	125	Marketing	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	126	Menaxhim Infermieror	100	5	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	127	Mësuesi Biologji-Kimi, me profil minor "Edukim Shëndetësor dhe Miedisor"	80	4	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	128	Mësuesi në Edukatë Qytetare me profil minor Gjeografi	50	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	129	Mësuesi në Edukatë Qytetare me profil minor Histori	50	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	130	Mësuesi në Gjuhë Angleze, me profil minor "Gjuhë Shqipe"	80	4	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	131	Mësuesi në Gjuhë Frengje me profil minor Gjuhë	30	2	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	132	Mësuesi në Gjuhë Italiane, me profil minor "Gjuhë Shqipe"	35	2	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	133	Mësuesi në Gjuhë Shqipe e Letërsi	80	4	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	134	Mësuesi në Gjuhë Gjermane, me profil minor në "Gjuhë Shqipe"	25	1	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	135	Mësuesi në Histori-Gjeografi me profil minor Edukatë Qytetare	60	3	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	136	Mësuesi në Matematikë-Fizike me profil minor Informatikë	70	4	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	137	Mësuesi në Matematikë-Informatikë me profil minor Fizike	30	2	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	138	Psikologji në Institucione	80	4	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	139	Punë Sociale me Femijët dhe Familjen	100	5	800	72,000
Univ. "A. Xhuvani" Elbasan	140	Redaktim	30	2	800	72,000
Akad. Mbrojtjes "S. Moisiu"	141	Siguri dhe Mbrojtje	50	3	800	72,000
Universiteti Sporteve Tiranë	142	Mësues në AM në Fiskulturë	110	4	800	72,000
Universiteti Sporteve Tiranë	143	Stërvitje Sportive	50	2	800	72,000
Universiteti Arteve Tiranë	144	Pikturë	45	2	1,200	108,000
Universiteti Arteve Tiranë	145	Skulpturë	10	1	1,200	108,000
Universiteti Arteve Tiranë	146	Studim Bastube	2	0	1,200	108,000
Universiteti Arteve Tiranë	147	Studim kitare	8	0	1,200	108,000
		TOTALI	8200	408		

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 4.10.2011
Doli nga shtypi më 4.10.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8
---------------------------	-------------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 60 lekë